ISSN 1857-6443

Johanes Han

Ballkani nuk funksionon siç dëshiron BE-ja

Fq.5

NURI BAJRAMI

Zgjedhjet në dioptrinë e Antikorrupsionit

Fq.6

I kam parë vetë krimet serbe

Fq.16-17

www.koha.mk

Koha

Fillimi i fundit të Erdoganit

Fq.10

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3625 · e mërkurë, 3 prill 2019 · 7°c | 19°c · 15 DEN

AKTUALE

Kërkesat e avokatëve nuk përfillen

Në një atmosferë të tensionuar dhe me plotë përplasje, të martën filloi procesi gjyqësor për rastin "Sazdovski". Kjo situatë u krijua pasi që pala mbrojtëse kërkoi anulimin e seancës, me qëllim përgatitjen më të mirë të mbrojtjes. Arsyeja e këtij propozimi të avokatëve Naser Raufi dhe Asmir Alispahiq, ishte se ato e kishin angazhuar neuro-psikiatrin Nikolla Sterjovski, si këshilltar teknik për parashtrimin e pyetjeve të kryqëzuara ndaj ekspertizës plotësuese e cila buroi nga rikonstruimi i ngjarjes. "Ekspertizën e kam...

Fq.8

FORUM

NATO në epokën e Putinit dhe Trumpit

Fq.11

RAJON

Berlini kthen sytë nga Tirana dhe Prishtina

Fq.14



VIZITË HISTORIKE E KRYEMINISTRIT GREK

DUHET TË VRAPOJMË, HUMBËM SHUMË KOHË

"Vizita ynë zyrtare sot paraqet hap historik të Ballkanit dhe Evropës. Ne jemi këtu për të gjetur zgjidhje dhe për të parë përpara, të ndërtojmë ura në vend të mureve", deklaroi Cipras pas takimit me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev

Fq.4

Të parët në Evropë me vdekshmëri në burgje

Strasburg, 2 prill - Sipas raportit për statistikën vjetore penale të Këshillit të Evropës për vitin 2018, të publikuar sot, Maqedonia e Veriut e ndjekë trendin evropian për ulje të shkallës së përgjithshme të të burgosurve. Përderisa në nivel të mbarë Evropës shkalla shënoi ulje për 6,6 për qind në periudhën mes viteve 2016 dhe 2018, duke u nisur prej 109.7 në 102.5 të burgosur në 100.000 banorë, Maqedonia e Veriut është në mesin e vendeve ku ajo shkallë më së shumti ka rënie - 9.7 për qind. Maqedonia e Veriut me 122.3 të burgosur për 100 vende, ndodhet në mesin e tetë vendeve të cilat kanë paraqitur problem të përgjithshëm serioz me stërngarkim në administratat e tyre të burgjeve. Pas Maqedonisë së Veriut pasojnë Rumania (120.5), Franca (116.3), Italia (115.0), Republika e Moldavisë (113.4), Serbia (109.2)...

Fq.7

ANALIZË

MËSIM PËR PRESIDENTIN POROSCHENKO

Nga Bernd JOHANN

Në zgjedhjet presidenciale në Ukrainë, komediani Selenski prin në rezultate. Raundi i parë ishte para së gjithash një votë proteste. Në zgjedhjet e balotazhit njerëzit do të shikojnë më me vëmendje

Pas raundit të parë të zgjedhjeve në Ukrainë, ai që prin është një komedian profesionist: komediani dhe star-i televiziv Vladimir Selenski. Ai mori gati dyfishin e votave në dallim nga ai që mban postin, Petro Poroshenko, i cili duhet të presë edhe për tri javë të tjera për rizgjedhjen e tij.

Rezultati është një shuplakë e rëndë për Poroshenkon. Pesë vjet të shkuara ai arriti një fitore të shkëlqyer që në raundin e parë të zgjedhjeve. Sot ai është larg kësaj mbështetjeje. Tepër i madh është zhgënjimi në Ukrainë për politikën e tij. Jo të gjitha reformat e shpallura u vunë në jetë. Disa kanë mbetur në vend, si për shembull lufta kundër korrupsionit. Edhe luftës me Rusinë në Donbass ai nuk i dha fund. Dhe para së gjithash: standardi i jetesës në Ukrainë vazhdon të jetë nga më të ulëtit në Evropë. Para fitojnë si më parë biznesmenët e pasur ukrainas, të ashtuquajturit oligarkë. Poroshenko i lë të qetë ata. Ai është vetë njëri prej tyre. Për këtë ai tani mori faturën. Por gjithsesi: ai vazhdon të jetë në garë. Në dallim nga Julia Timoshenko. Ëndrra e saj për postin e presidentit dështoi që në raundin e parë të zgjedhjeve. Si në rastin e Poroshenkos, edhe asaj ia prishi llogarinë fitorja e Selenskit. Ajo donte t'i merrte vota Poroshenkos vota me programin tipik populist për të. Zgjedhësit tradicionalë të saj ajo arriti t'i mobilizonte me të, por më tepër jo.

Timoshenko doli nga loja, Poroshenko është ende në lojë - të dy politikanët mishërojnë në thelb një brez të vjetër politikanësh, të cilin shumë ukrainas nuk e duan më. Selenski u ofron këtyre njerëzve alternativë. Me shumë siguri, ky raund i parë zgjedhjesh ishte para së gjithash një votë proteste. Sepse megjithë zhgënjimin për Poroshenkon shumë ukrainas i preokupon edhe çështja si do të ishte Selenski me të vërtetë si President. Ata e njohin vetëm si zbavitës dhe para së gjithash nga një seri televizive, në të cilin ai luan Presidentin e Ukrainës. Programi i tij, për aq sa mund të flitet për një program, është tepër i mjegullt. Në fushatën elektorale ai thuajse nuk dha intervista, nuk shkoi në debate politike. Ai udhëtoi me trupën e tij të kabaresë nga qyteti në qytet.

Ukrainasit do të ndodhen në raundin e dytë të zgjedhjeve para një vendimi të vështirë: ose do t'ia japin votën pushtetmbajtësit, të cilin shumë vetë nuk e duan më. Ose do të votojnë për sfiduesin e tij, objektivat politike të të cilit ata vetëm mund t'i marrin me mend në vija të trasha. Zgjedhje me përfundim të pasigurt. *(DW)*



SHPRESOJ QË OSBE TË MOS E MERR SERIOZISHT ANA BRNABIQIN

Ish-ambasadori i Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Robert Bosch i ka reaguar kryeministres së Serbisë, Ana Brnabiq për deklaratat se serbët e Kosovës nuk po mund të informohen pas vendosjes së tarifës prej 100 për qind nga Qeveria, për shkak se gazetat nuk po munden të hyjnë nga Serbia për në Kosovë.
Përmes një shkrimi në Facebook, Bosch është deklaruar se ky qëndrim i Brnabic është qesharak.
"Fillimisht, në çfarë shekulli është duke jetuar zonja, shumica e njerëzve marrin lajmet përmes mediave sociale si përmes radio, televizionit e portaleve. Taksa prej 100 për qind për të gjitha produktet serbe e boshnjake është përgjigje ndaj politikës agresive serbe.Pastaj tarifa është një përgjigje ndaj politikës agresive anti-kosovare që qeveria e saj parashtron dhe së fundi mund të paguhet tarifa nëse duan që të informohen.
Shpresoj që OSBE të mos e merr seriozisht këtë lidere që nuk punon as për të i dhënë të drejta mediave në shtetin e vet, ka shkruar Robert Bosch.



TË RINJTË MË PËRPARA I ËNDËRROJNË VIZAT SE NJË VEND PUNE

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka reaguar pas publikimit të raportit të "Eurostat" se Kosova është vendi me zbrazjen më të mdhe të popullsisë në Evropë që nga viti 2007. Konjufca përmes një postimi në Facebook ka shkruar se, ikje e qytetarëve të Kosovës është bërë për shkak të gjendjes ekonomike dhe mos perspektivës në vend
Postimi i plotë:'Eurostati tha: Kosova - vendi me zbrazjen më të madhe të popullsisë në Evropë prej vitit 2007. Pothuajse sa katërfishi i Shqipërisë. Dhe sa dy herë Bosnja e Hercegovina. Një nga shtetet me natalitetin më të lartë në kontinent, pra, në të njëjtën kohë po e përjeton ikjen më të madhe të qytetarëve. Në këtë gjendje ekonomike pa perspektivë, numri i atyre që duan ta lëshojnë Kosovën është fatkeqësisht i madh. Vetë fakti që shumë vajza e djem sot në vendin tonë më përpara i ëndërrojnë vizat se një vend pune, tregon më së miri për krizën e thellë sociale e cila e ka pllakosur popullin tonë. Por tragjedia e vërtetë politike është kjo: i vetmi plan që ka Qeveria për ta zgjidhur këtë problem është liberalizimi i vizave. Dëshpëruese dhe e pafalshme', konkludon Konjufca.

MEDIACitate

JO MË PAJISJE PËR AVIONËT LUFTARAKË TURQ

Në shenjë pakënaqësie për shkak të instalimit të sistemeve raketore ruse në Turqi, qeveria e SHBA reagoi duke ndalur furnizimin e Turqisë me materiale pajisjeje për avionët luftarakë F35. Për sa kohë qeveria turke nuk heq dorë nga sistemi i mbrojtjes ajrore ruse, S-400, furnizimet dhe aktivitetet e tjera lidhur me avionët F35 do ta ndalen, bëri të ditur Ministria e Mbrojtjes së SHBA. E kemi bërë të qartë, se blerja e sistemit S-400 është e papranueshme për ne. Ky është hapi i parë konkret i SHBA që ndërpret furnizimin për aleatë të NATO-s. Pentagoni theksoi në të njëjtën kohë, se dialogu për këtë po vazhdon. Kurse nga pala turke nuk ka prononcime.
Turqia ka rënë në ujdi për të blerë nga Moska sistemet raketore, S-400 për mbrojtjen ajrore. Në të njëjtën kohë Ankaraja dëshiron të marrë nga SHBA avionë ushtarakë F35, kundër të cilave teorikisht mund të përdoret sistemi raketor rus S-400. Turqia thotë, se do ta ketë gati sistemin rus nga tetori i këtij viti. Me këtë ky vend bëhet shteti i parë i NATO-s që mbështetet tek sistemet e armëve ruse, e që cilësohen si jo të përshtatshme me sistemet e NATO-s. Blerja e sistemit raketor rus është prej kohësh një mollë sherri mes Turqisë dhe SHBA. Në një analizë të revistës "Interesi Kombëtar" në korrik të vitit të kaluar, theksohet se shqetësimi më i madh i amerikanëve është "përzierja" e produktit rus me avionët amerikanë. Nëse Turqia i ka të dyja, ajo mund të testojë, se sa i aftë është sistemi i mbrojtjes kundër avionëve ushtarakë, të dhëna, të cilat Rusia mund t'i marrë përmes Turqisë. Qeveria në Ankara i ka hedhur poshtë kritikat e aleatëve që në marrëveshjen për blerjen në vitin 2017. Ajo do t'i marrë raketat ruse në dorëzim në korrik.

(DW, 2 prill)

PUBLIKOHET RAPORTI PËR EKONOMINË E RAJONIT

INSTITUCIONE TË DOBËTA SHTETËRORE VËREN BANKA BOTËRORE

"Sfidat kryesore për rritjen janë produktiviteti i ulët dhe produktiviteti gjithnjë e më i vogël i firmave lokale, institucionet e dobëta shtetërore, kapitali i ulët njerëzor, mospërputhja e aftësive dhe ndryshimet në kërkesën e tregut të punës dhe pengesat ndaj politikave publike në aspektin e konkurrencës dhe investimeve", thuhet në raport

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 2 prill - Banka Botërore mbetet në parashikimet për rritjen ekonomike të vendit e cila këtë vit arrin në 2.9 për qind dhe pret rritje graduale të saj në 3.2 për qind vitin e ardhshëm. Në raportin e rregullt pranveror ekonomik për Ballkanin Perëndimor i cili u prezantua sot, vlerësohet se perspektiva ekonomike e vendit është pozitive dhe rekomandohet pas rezultateve të përmirësuara politike theksi të vendoset mbi reformat ekonomike. Rritja prej 2.9 për qind e BB është parashikuar edhe për Malin e Zi, ndërsa për Shqipërinë vlerësohet rritje ekonomike prej 3.8 për qind, Bosnjën e Hercegovinën 3.4 për qind, Kosovën 4.4 për qind dhe Serbinë 3.5 për qind.

"Sfidat kryesore për rritjen janë produktiviteti i ulët dhe produktiviteti gjithnjë e më i vogël i firmave lokale, institucionet e dobëta shtetërore, kapitali i ulët njerëzor, mospërputhja e aftësive dhe ndryshimet në kërkesën e tregut të punës dhe pengesat ndaj politikave publike në aspektin e konkurrencës dhe investimeve", thuhet në raport . Burim i qëndrueshëm i rritjes pritet edhe mëtej të jetë konsumi si dhe eksportet nga investimet e huaja të drejtpërdrejta, thuhet në raportin e Bankës Botërore. Zgjidhja e çështjes së emrit pritet t'i përshpejtojë negociatat e inkuadrimit në BE, gjë që do të rrisë besimin e investuesve dhe do ta stimulojë rritjen në vitet e ardhshme. Projektet e mëdha infrastrukturore, sidomos rrugët, si dhe ndërprerja e moratoriumit të autoriteteve lokale për lëshimin e lejeve të ndërtimit, sipas BB, do të stimulojë mëtej investimet.

Skenari fiskal i qeverisë për rritjen e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së në 54.4 për qind në vitin e ardhshëm, sipas Bankës Botërore, kërkon reforma të forta strukturore për të stabilizuar borxhin. Pritet, siç potencoi, rritje e borxhit publik për shkak të përshpejtimit të ndërtimit të autostradave, por pas përfundimit të tyre do të zvogëlohet. Banka Botërore, në rekomandimet, siç tha Sanja Maxharoviq Shujster, ekonomiste e lartë për BB në rajon, beson gjithashtu se efekti i investimeve të huaja të drejtpërdrejta në ekonominë lokale duhet të sigurohet duke rritur përpjekjet e furnizuesve lokal të cilët duhet të punojnë sipas standardeve.

Në tregun e punës, siç shtoi prej çdo 100 banorëve 26 janë të punësuar, nga të cilat tetë në sektorin privat dhe 18 në sektorin publik. Kjo, thekson ajo, është një varësi shumë e madhe, shumë pak njerëz fitojnë të ardhura dhe paguajnë taksa me të cilat paguhen shërbimet ndaj të tjerëve, siç janë grupet e papunë, të rrezikuara… Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, ajo theksoi se nevojitet një reformë gjithëpërfshirëse e administratës publike jo vetëm për nevojat e efikasitetit fiskal, por edhe si pjesë e kushteve për t'u inkuadruar me Bashkimin Evropian. Shpenzimet fiskale të administratës duhet të jenë të kufizuara, ndërsa në të njëjtën kohë synojmë ta përmirësojë cilësinë e shërbimeve. Raporti i rregullt ekonomik i BB për Ballkanin Perëndimor është titulluar "Nevojitet përshpejtim i reformave" . Në të potencohet se pavarësisht rritjes më të fortë në rajon vitin e kaluar, u krijuan më pak vende pune, domethënë vetëm 96,000, gjë që u pasqyrua në dinamikën e kufizuar në sektorin privat, papunësia është zvogëluar, por mbetet e lartë për gratë dhe të rinjtë.

Publicitet

VIZITË HISTORIKE E KRYEMINISTRIT GREK

DUHET TË VRAPOJMË, HUMBËM SHUMË KOHË

"Vizita ynë zyrtare sot paraqet hap historik të Ballkanit dhe Evropës. Ne jemi këtu për të gjetur zgjidhje dhe për të parë përpara, të ndërtojmë ura në vend të mureve", deklaroi Cipras pas takimit me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 2 prill - Vizita ime këtu është vizita e parë zyrtare e një kryeministri grek në vendin tuaj. Humbëm shumë kohë. Duhet të vrapojmë dhe shpejtojmë, sepse humbëm tre dekada. Duhet t'i kalojmë të gjitha këto hendeqe dhe t'i tejkalojmë. Të kalojmë nga historia dhe luftërat dhe narrativa e ndarjeve dhe të tentojmë të ndërtojmë narrativë të re, të bashkëpunimit dhe rritjes së re. Këtë nga Shkupi e deklaroi kryeministri grek, Aleksis Cipras, ndërsa theksoi se Greqia do të vazhdojë me mbështetjen e Maqedonisë së Veriut në përpjekjet e saj për të vazhduar me reformat e domosdoshme dhe për t'u bërë pjesë e BE-së.

"Vizita ynë zyrtare sot paraqet hap historik të Ballkanit dhe Evropës. Ne jemi këtu për të gjetur zgjidhje dhe për të parë përpara, të ndërtojmë ura në vend të mureve", deklaroi Cipras pas takimit me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev. Ai theksoi se në nivel të marrëdhënieve diplomatike krijuan ambasada dhe do t'i zëvendësojnë pikat e kontaktit që i kanë pasur deri më tani. "Para disa muajve Greqia ishte shteti i parë që e ratifikoi protokollin inkuadrues për shtetin tuaj drejt NATO-s, ndërsa sot nënshkruam memorandum për mirëkuptim dhe avancim të proceseve parainkuadruese dhe inkuadruese të Maqedonisë së Veriut në BE", porositi Cipras, ndërsa theksoi se çështja më e rëndësishme në takimin e sotëm ishte ekonomia, sepse, siç tha, duhet të përshpejtojmë dhe t'i tejkalojmë hendeqet nga e kaluara, si dhe të evitojmë tatimimin e dyfishtë.

"Krahas vështirësive ka shumë sipërmarrës grekë të cilët për momentin punojnë dhe janë aktivë në Maqedoninë e Veriut. Megjithatë, delegacioni im sjell me vete mbi qindra sipërmarrës, e tërë kjo me qëllim që të arrihet bashkëpunim më i mirë dhe marrëdhënie më të mira në të ardhmen. Vendosëm edhe komitet koordinues për bashkëpunimin tonë, që do të kryejë mbikëqyrje dhe do t'i mbështesë ndërhyrjet e tilla në suaza të marrëdhënieve ekonomike", deklaroi Cipras. Marrëveshja për mbrojtje e nënshkruar mes të dy MPJ, theksoi Ciprasi, paraqet dëshmi për vullnetin e Greqisë të ndihmojë në ndërtimin e mundësive të mbrojtjes dhe kapacitetet e Maqedonisë së Veriut. "Ky bashkëpunim është i rëndësishëm dhe përfshin shumë sektorë. Këtu janë trajnimet, industria e mbrojtjes, mbrojta kibernetike, shërbimi ushtarak për zbulim, si dhe politika ajrore", deklaroi Ciprasi. Greqia, vazhdoi Ciprasi do të bëjë trajnimin e kontrollit ajror përmes Selanikut, me qëllim që të sigurisë ajrore mbi sipërfaqen ajrore të Maqedonisë së Veriut.

Që të kemi themele të fuqishme për bashkëpunim mes të dy vendeve të qëndrueshme, Ciprasi përmendi se duhet të punojmë intensivisht për zbatimin e saktë të Marrëveshjes së Prespës. "Në këtë periudhë të shkurtër ne ndërmarrim hapa të mëdha për të ecur para dhe kështu duhet të vazhdojmë edhe në të ardhmen. Me rëndësi është të ketë institucione në të dy vendet që do të bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë dhe të bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes", deklaroi Ciprasi.

FITORE E POLITIKËS SË PËRPARIMIT

Kryeministri Zaev nga ana e tij përkujtoi se për herë të parë në histori një kryeministër grek gjendet për vizitë në vend, duke potencuar se kjo vizitë historike është shprehje e fuqishme e vullnetit të përbashkët politik dhe shenjë e qartë për zgjidhjen e çështjeve të hapura si kontribut për një Ballkan të ri. "Më 17 qershor të vitit të kaluar kur të dyja vendet tona e nënshkruan Marrëveshjen e Prespës shkruajmë histori disa herë. Greqia është vendi i parë që e ka nënshkruar Protokollin për anëtarësim në NATO, që është synimi i ynë strategjik, ndërsa kryeministri Aleksis Cipras i bëri thirrje BE-së të fillojë negociata për anëtarësimin e shtetit tonë. E gjithë kjo është për fitore të politikës së përparimit, për paqe dhe miqësi midis popujve", tha Zaevi në takimin me Ciprasin. Ai theksoi se verdikti politik, miqësia dhe besimi i ndërtuar muajve të kaluar, na kanë sjellë deri në seancën e sotme të Këshillit të Lartë për Bashkëpunim midis të dyja vendeve, ku e nënshkruan Planin Veprues për përforcimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës konform Marrëveshjes së Prespës.

"Kur shihni në drejtim të së kaluarës shihni raste të cilat nuk janë shfrytëzuar, kur do të shihni në të ardhmen shihni mundësi të hapura dhe interesa të përbashkëta. Të dy fqinjët morën vendime të guximshme me dëshirë për bashkim, ndërsa ajo që dukej për pamundësi sot është realitet", theksoi Zaev. Tha edhe se janë dakorduar deri në mes të majit ekipi i përbashkët i ekspertëve për përdorim komercial të emrit, terminologjisë, brendeve dhe shtoi se me rëndësi të madhe janë memorandumet e nënshkruara në fushën e transportit dhe bisedimet për energjetikën, bashkëpunimet të cilat e përmirësojnë jetën e qytetarëve të të dyja vendeve. "Muajve mbrapa fitova një mik të mirë. Aleksis është shoku im dhe mik i vendit tonë. Rekomandoj të gjithë ne të ndërtojmë miqësi me fqinjin tonë Greqinë, dhe me fqinjët tanë të tjerë", theksoi kryeministri Zaev.

BASHKËPUNIM EDHE NË BUJQËSI

Përpilimi i memorandumit për bashkëpunim në të cilin do të përfshihen ekipet e të dyja palëve, u dakorduan në takimin e djeshëm bilateral të ministrit të Bujqësisë, Lupço Nikollovskit dhe kolegut të tij grek, ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Stavros Arhovitis. "Tani është momenti i vërtetë për intensifikimin e bashkëpunimit tregtar greko-maqedonas në pjesën e produkteve bujqësore-ushqimore", porositi Arahovitis në takim.

Siç kumtoi MBPEU, Nikollovski dhe Arahovitis u dakorduan që të dy ministritë të punojnë në shkëmbimin e përvojave, ndihmën e ekspertëve, si dhe inicimin e bashkëpunimit në mesin e rajoneve në vend dhe në Greqi, që janë të njohur me prodhimin e orizit. Bashkëpunimi në pjesën e prodhimtarisë së orizit do të nënkuptonte mbështetje të mëtutjeshme në Institutin e orizit në Koçan dhe përcjellja e përvojës nga ana e Institutit për oriz në Greqi, si dhe iniciativa për zhvillimin lokal përmes vendosjes së bashkëpunimit midis komunave që janë rajone të rëndësishme për prodhimin e orizit në të dyja shtetet. Të dy ministrat u pajtuan se është i nevojshëm veprimi i përbashkët për mbrojtjen e rezervave të peshkut, marrëveshje për kuota të peshkimit dhe mbledhjen e të dhënave për ujërat e përbashkëta të peshkimit - në Liqenin e Dojranit dhe të Prespës, që është në interes të të dyja vendeve.

Sipas Nikollovskit dhe Arahovitisit, së bashku duhet të punohet në qëndrueshmërinë e zhvillimit rural dhe mjediset rurale respektivisht në rajonin kufitar.

BASHKË PËR SHËNDETËSINË

Edhe ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe në Qeveri u takua me ministrin grek të Shëndetësisë, Andreas Ksantos, në kuadër të vizitës zyrtare të kryeministrit të Republikës së Greqisë, Aleksis Cipras në Shkup. Në takim, kumtoi Ministria e Shëndetësisë, dy ministrat kanë biseduar për përforcimin e bashkëpunimit midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë në sferën e sektorit shëndetësor përmes nxitjes së trajnimeve, programeve shkencore dhe këmbimit të universiteteve, spitaleve dhe institucioneve tjera shëndetësore.

Sferat nga interesi i përbashkët për këmbim të njohurive dhe për zbatimin e projekteve janë: mobilizimi i fondeve strukturore të BE-së, veçanërisht mjete nga Interreg, për zbatimin e projekteve ndërkufitare në sektorin shëndetësor; sigurim i ekspertizës në sferën e shëndetit mental (deinstitucionalizim, shërbime për shëndet mental në bashkësi, rehabilitim psikosocial dhe profesional) dhe varësi nga droga (parandalim, terapi supstituiona, të a.q. programe "të thata" dhe rehabilitim psikosocial); bashkëpunim në sferat e sëmundjeve infektuese (veçanërisht të sëmundjeve vektoriale) dhe çështje nga shëndeti publik. si dhe sistemi për Ndihmë urgjente mjekësore dhe sigurim të ekspertizës dhe mbështetje teknike gjatë sigurimit dhe menaxhimit të gjakut dedikuar për transfuzion, duke përfshirë edhe serologji dhe testim molekular.

Ndryshe, Zaevi bashkërisht me Ciprasin e kanë hapur Forumin e biznesit në të cilin marrin pjesë mbi 400 afaristë të të dyja vendeve, ndërsa dy kryeministrat u zotuan se me këtë forum do të ripërtërihen hapësirat historike që do të krijojnë mundësi për shkëmbim të investimeve, tregtisë dhe kulturës.

MARRËVESHJA E PRESPËS, PROCES I PAKTHYESHËM

Pavarësisht se cila parti i fiton zgjedhjet e ardhshme parlamentare si në Greqi apo Maqedoninë e Veriut, ajo nuk do ta ketë të drejtën sovrane për shfuqizimin e Marrëveshjes së Prespës. Kjo ishte përgjigja dy kryeministrave - atij të Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, Aleksis Cipras dhe Zoran Zaev në pyetjen lidhur me implementimin e ardhshëm të Marrëveshjes së Prespës dhe nëse e njëjta rrezikohet me ndryshimin e qeverive në dy vendet nënshkruese. "Asnjë shtet në botë apo politikan deri më sot nuk ka shfuqizuar ndonjë marrëveshje bilaterale të arritur midis dy shteteve fqinje. Edhe sikur në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Maqedoninë e Veriut të fitojë zgjedhjet dikush tjetër dhe të miratojë vendim për anulimin e Marrëveshjes së Prespës, atëherë kjo do të thotë se janë kundër NATO-së dhe çeljen e bisedimeve më BE-në. Pra, anulimi i Marrëveshjes së Prespës është një proces i pakthyeshëm për shkak se pas marrëveshjes qëndrojnë të gjitha shtetet më të fuqishme botërore, si SHBA, Gjermania, Britania e Madhe, Franca dhe së fundmi - me njohjen e Maqedonisë me emrin e ri, edhe Rusia", deklaroi Zoran Zaev, kryeministri i RMV-së.

KATROUNGALOS PËR MARRËVESHJEN E PRESPËS

TË PRESIM PËRFITIMET EKONOMIKE

Marrëveshja e Prespës kundërshtohet nga forcat nacionaliste në të dy vendet, opozita e shfrytëzon për të fituar kapital elektoral. Ministri i Jashtëm grek Katroungalos thotë çfarë duhet bërë për zbatimin e marrëveshjes

Athinë, 2 prill - Giorgos Katroungalos flet me qetësi. Ministrit të Jashtëm grek i duhet qetësia dhe durimi, durimi për të bindur qytetarët e vendit të vet, se marrëveshja e Prespës, është në favor edhe të Greqisë. Të hënën (01.04), ministri Katroungalos i ftuar nga Prof. David Phillips foli në Harriman Institut për zbatimin e marrëveshjes së Prespës. Në publik ndodheshin studentë, profesorë të Universitetit Columbia, diplomatë, punonjës të OKB dhe migrantë grekë që jetojnë në Nju Jork. "Ne e konsiderojmë Marrëveshjen e Prespës, model për zgjidhjen e konflikteve në Ballkan me diplomaci dhe dialog dhe jo me dhunë dhe kërcënime", thotë ministri grek, "sepse ka ende nacionalizëm në rajonin tonë". Ballkani mund të jetë një hapësirë e unifikuar ekonomike, thotë ministri Katroungalos, duke e quajtur pjesë të strategjitë se vendit të vet, promovimin e perspektivës europiane të Ballkanit Perëndimor dhe marrëdhënieve të mira ekonomike, tregtare.

Në Greqi ka reagime shumë emocionale kundër marrëveshjes, shpjegon ministri. Një nga frikërat që kanë disa qytetarë të Greqisë është se produktet me emrin Maqedoni do të eksportohen më pak. "Kjo ka ndodhur në të kaluarën, sepse fqinji ynë e ka përdorur këtë emër pa kriter," thotë ministri. Përdorimi i këtij emri në produkte nuk ka qenë rregulluar me ligj kombëtar, por nga tregu. "Marrëveshja e Prespës është lidhur midis shteteve. Tani duhet të lidhet edhe nga sektori i biznesit privat të të dy vendeve", thotë Katroungalos. Dhomat e tregtisë duhet të merren me këtë çështje.

Sa të vështirë e kanë politikanët grekë të bindin qytetarët e vendit të vet e tregon një pjesë e publikut në sallë. Qytetarë grekë që jetojnë në Nju Jork ankohen, ndërpresin bisedën, largohen në shenjë proteste dhe një djalë i ri që merr fjalën thotë gati duke qarë se Marrëveshja e Prespës nuk është e drejtë, sepse i "jep identitetin qytetarëve të Maqedonisë". Nuk është hera e parë që ministri i Jashtëm e dëgjon këtë. "Qeveria greke është akuzuar se ka përdorur në kapitullin e parë të Marrëveshjes së Prespës termin "nationality", si term që i referohet etnitetit të fqinjëve tanë. Të dy qeveritë e kanë bërë të qartë se termi "nationality" ka të bëjë me nënshtetësinë, jo me nacionalitetin. Nënshtetësia është ajo që lidh qytetarin me shtetin", shpjegon ministri grek Giorgos Katroungalos.

"Sa i përket identitetit, vazhdon ai më tej, ne nuk mund të diktojmë fqinjët tanë për çështjet e identitetit. Ajo që kemi bërë ne është që në marrëveshje, në artikullin 7 e bëjmë të qartë se Maqedonia antike nuk ka të bëjë me Maqedoninë Veriore. Po ashtu kultura dhe trashëgimia e tyre nuk është e njëjtë me tonën". "Shumë grekë nuk duan që fjala Maqedoni të përdoret nga një vend fqinj". Ministri i Jashtëm këshillon të gjithë qytetarët që të lexojnë marrëveshjen. Ai mendon se pala maqedonase e ka më të lehtë të shohë të mirat nga marrëveshja, sepse pas saj u hap perspektiva euroatlantike për vendin. Kurse pala greke duhet të presë të shohë për shembull përfitimet ekonomike që vijnë nga marrëveshja. "Njerëzit duhet të shohin rezultatet ekonomike të marrëveshjes", thotë ministri i Jashtëm. Po ashtu duhet punuar me të rinjtë, duhet të pastrohen librat e shkollave nga nacionalizmat. "Ballkani duhet të kthehet në hapësirë të lirë ekonomike, jo me forca hegjemoniste, dhe ne duam të jemi protagonistë të këtij procesi", thotë ministri i Jashtëm grek, Giorgos Katroungalos. *(DW)*

HATÇINSON PËR MIRATIMIN NGA KONGRESI AMERIKAN

PROTOKOLLI PËR MAQEDONINË NË NATO, NË VJESHTË

Hatçinson edhe njëherë konfirmoi se protokolli për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Aleancë pritet të miratohet nga Kongresi amerikan këtë vjeshtë

Uashington, 2 prill - Aleatët do ta përforcojnë praninë e tyre në rajonin e Detit Mesdhe si përgjigje ndaj agresionit rus në Ukrainë dhe NATO këtë vit është duke u zgjeruar me Maqedoninë e Veriut si anëtarja e 30-të me radhë, deklaroi ambasadorja amerikane në NATO, Kej Bejli Hatçinson. Në një video në pres konferencën e organizuar mbrëmë në pritje të shënimit të 70-vjetorit të krijimit të NATO-s, që me dy evente të ndara do të mbahet me këshillin ministror gjatë kësaj jave në Uashington dhe me samitin e liderëve në dhjetor në Londër, Hatçinson tha se Rusia vazhdon ta destabilizojë Ukrainën dhe ta militarizojë gadishullin e Krimesë.

"Agresioni me konfiskimin e anijeve ushtarake ukrainase dhe ndalimin e marinarëve është tërësisht e papranueshme dhe bëjmë thirrje ata menjëherë të lirohen", deklaroi Hatçinson. Ajo shtoi se aleatët do ta përforcojnë praninë në rajonin e Detit të Zi, me më shumë mbikëqyrje të terrenit dhe praninë gjithnjë e më të madhe ushtarake me anije të vendeve të NATO-s. Lidhur me vendimin e shënimit të 70-vjetorit të mbahet me dy raste të ndara, në Uashington dhe në Londër, Hatçinson tha se kryeqendra amerikane do të jetë nikoqire e këshillit të ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të NATO-s, ndërsa në Londër do të mbahet samit i liderëve.

"Marrëveshja për krijimin e Aleancës u nënshkrua më 4 prill, por për shkak të asaj që para më pak se një vit patëm samit të liderëve ishte më logjike në Uashington të shënohet me këshillin ministror, derisa Londra nuk ofrohet të jetë nikoqire e samitit, i cili me siguri do të mbahet këtë vit në dhjetor", zbuloi ambasadorja. Ajo tha se menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes në vitin 1949, Londra ka qenë selia e parë e NATO-s dhe kryeqendra britanike ka kërkuar atje të shënohet 70-vjetori. Hatçinson edhe njëherë konfirmoi se protokolli për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Aleancë pritet të miratohet nga Kongresi amerikan këtë vjeshtë. "Në Evropë, kontinent i cili ishte ndarë prej luftërave, mbisundon paqja për 70 vite dhe ky është sukses i madh... Nga 12 anëtare në 29, ndërsa deri në fund të këtij viti edhe me të 30-ën, NATO vazhdon të luaj rol kyç në paqe dhe stabilitet në Evropë", deklaroi ambasadorja Kej Bejli Hatçinson.

HANI ME VËREJTJE PËR PARLAMENTET E RAJONIT

Ballkani nuk funksionon siç dëshiron BE-ja

Bruksel, 2 prill - Komisari evropian për zgjerim, Johanes Han, në intervistë për "Agjencinë Evropa" vëren se parlamentet në shumë vende të Ballkanit Perëndimor ende nuk funksionojnë sipas standardeve evropiane. "Në Ballkan ekziston ai mentalitet bardhë apo zi. Ose jeni fitues, ose jeni humbës. Por, në demokraci, element kyç është kompromisi, ndërsa kompromisi shpesh ka konotacion negativ në Ballkanin Perëndimor, por në të vërtetë kjo do të thotë se secili duhet t'i japë diçka tjetrit për të marrë diçka plus", thotë Han në intervistë. Ai konsideron se ky problem nuk u përket vetëm politikanëve, dhe se ata politikanë të cilët tregojnë aftësi për kompromis janë "në njëfarë mënyre shembull i keq për njerëzit". "Prandaj investuam aq në përforcimin e parlamentit, ajo është sferë kyçe, siç mund të konstatoni në shumicën e vendeve, parlamenti nuk funksionon siç dëshirojmë", thotë komisari. Ai distancohet nga kualifikimet se bëhet fjalë për "stil ballkanik" dhe thekson se probleme të ngjashme paraqiten në fqinjësinë lindore të BE-së, por edhe në atë jugore, si për shembull në Tunizi.

Komisari për zgjerim ende nuk mund të garantojë se do të hapen negociatat në qershor, por insiston se vendet të cilat kanë më së shumti rezerva ndaj procesit duhet të jenë të vetëdijshme se bëhet fjalë për kredibilitetin e Bashkimit Evropian. Ai e potencoi edhe raportin paradoskal të atyre vendeve të cilat janë më kritike ndaj ndikimeve të huaja në rajon, ndërkaq njëkohësisht janë edhe më rezistente ndaj zgjerimit. "Nëse ka vakuum, një vend tjetër do ta plotësojë. Çdoherë ekziston rreziku, posaçërisht në Bosnjë e Hercegovinë, për paraqitje të forcave radikale, fundamentalistëve fetarë dhe të tjerëve të cilët i shënjestrojnë të rinjtë, dhe kjo krijon rrezik për ne", paralajmëroi Han. Kredibiliteti i BE-së, thotë ai, është element kyç. Nuk mund të kërkohen reforma dhe përpjekje nga vendet në rajon, ndërsa nga ana evropiane të mos përmbushen premtimet. "Jo vetëm që do ta humbim kredibilitetin tonë, por edhe ndikimin tonë politik, dhe më shpesh ata të cilët e kritikojnë ndikimin e Rusisë, Kinës, Turqisë në Ballkan kanë rezerva për ta njohur përparimin e vendeve nga Ballkani Perëndimor drejt BE-së", theksoi Han. Ai përkujton edhe se rajoni paraqet treg të rëndësishëm ekonomik për BE-në.

"Zgjedhjet në këtë fazë do të mund t'i përcjellim nga ajo që do të paraqitet, nga aplikacionet e prezantuara. Por, edhe nga të gjithë faktorët tjerë relavant me të cilët kemi nënshkruar dhe ndërtuar bashkëpunim, ndërsa pas zgjedhjeve ka plane që të ekipohet sekretariati i Komisionit në mënyrë që të mund të arrijë që të ushtroj kompetencat sipas ligjit të ri", deklaroi për gazetën KOHA, Nuri Bajrami

PARANDALIMI I KORRUPSIONIT

ZGJEDHJET NË DIOPTRINË E ANTIKORRUPSIONIT

Koha Destan JONUZI

Shkup, 2 prill - Ndarja e politikës nga shteti në Maqedoninë e Veriut është e vështirë, ose nuk kuptohet si duhet. Tanimë kur fushata për zgjedhjet presidenciale të 21 prillit ka filluar, nga Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit thonë se këto zgjedhje do t'i ndjekin me kapacitet të pamjaftueshme teknik dhe kadrovik, por se do të shfrytëzojnë edhe ndihmën e organizatave me të cilat kanë lidhur Memorandume bashkëpunimi.

"Zgjedhjet në këtë fazë do të mund t'i përcjellim nga ajo që do të paraqitet, nga aplikacionet e prezantuara. Por, edhe nga të gjithë faktorët tjerë relavant me të cilët kemi nënshkruar dhe ndërtuar bashkëpunim, ndërsa pas zgjedhjeve ka plane që të ekipohet sekretariati i Komisionit në mënyrë që të mund të arrijë që të ushtroj kompetencat sipas ligjit të ri", deklaroi për gazetën KOHA, Nuri Bajrami, nënkryetar i Komisionit për parandalimin e korrupsionit. Bajrami thekson se Komisioni për Antikorrupsion përbëhet prej shtatë anëtarëve ndërsa si shërbim profesional ka sekretariatin i cili për momentin numëron vetëm se 20 anëtarë, që është numër i vogël për të ushtruar kompetencat sipas ligjit të ri.

Ndërsa për gjykatësit "svarovski", të cilët u apostrofuan në Raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), numri dy i Antikorrupsionit thotë se si të gjithë personat tjerë të zgjedhur dhe emëruar, as gjykatësit nuk mund të bëjnë përjashtime nga puna të cilën sipas ligjit e kryen komisioni. "Gjykatësit nuk janë asgjë më shumë se sa njerëz të zgjedhur, të emëruar dhe të caktuar në një detyrë dhe nuk ka nevojë të bëhet përjashtime për cilin do qoftë. Korrupsioni mund të jetë gjithkund. Ne nuk merremi me target grupe siç merret policia dhe prokuroria. Ne merremi me dyshime, prandaj edhe emrin e ka Komisioni për parandalimin e Korrupsionit. Për të gjitha dyshimet jemi të detyruar të ngremë iniciativa që mos fillojnë dukurit të rriten, sepse rritja e dukurive korruptive, rrit edhe paratë korruptive dhe ato para nuk ke ku ti investosh përveç se në korrupsion", nënvizon Bajarami.

Përndryshe, së fundmi Komisioni për parandalimin e korrupsionit ka ngritur mbi 40 lëndë për nepotizëm për ishfunksionarë dhe funksionarë aktual. Ende asnjë nga këto lëndë nuk ka marrë epilog përfundimtar, ndërsa Bajrami përjashton presionin politik ndaj komisionit.

KANDIDATI I PAVARUR FUSHATËN E NISI NGA SHESHI SKENDERBEU

Vota për Rekën, votë kundër aksham pazareve

Shkup, 2 prill - Të hënën mbrëma në sheshin Skenderbeu, në zemrën e Shkupit, filloi fushata presidenciale, ku kandidati për president, Prof. Blerim Reka, mbajti konventën e tij të parë promovuese. Me moton "Reka për Republikën", kandidati për president, prof. Reka, i shoqëruar nga kreu i Aleancës për Shqiptarët (ASH), Ziadin Sela dhe i Lëvizjes BESA, Bilall Kasami, në praninë e mijëra qytetarëve shpalosën mbështetjen e tyre për kandidimin presidencial të prof. Blerim Rekës. Ata shprehën arsyet se përse po e mbështesin këtë kandidaturë presidenciale, si dhe sa do të ishte e padrejtë për votuesin shqiptar sikurse këto zgjedhje të mos e kishin asnjë kandidat shqiptar. Kandidati për president, Prof. Blerim Reka duke iu drejtuar qytetarëve theksoi se sonte këtu, në Shkup, Ju qytetarë të pranishëm, po dëshmoni konsensualitetin midis shqiptarëve. "Prania juaj është ujdia e shqiptarëve të bashkuar, sepse shqiptarët e përçarë, paraprakisht duhet të arrijnë konsensusin me vëllain, sesa konsensus me fqiun. Mos lejoni t'ju bindin që edhe pas 30 vitesh ju duhet të mos votoni vetveten. Me 21 prill bëhuni vetvetja", theksoi kandidati për president, Prof. Blerim Reka. Ai bëri thirrje që vota e qytetarëve të shkojë atje ku duhet dhe të mos shitet. "Votoni kundër aksham pazareve dhe mos e mundësoni, me votën tuaj nga patriotë tenderistë. Vota juaj është e shenjtë, as nuk shitet e as nuk falet. Ajo është e juaja. Dilni masovikisht, pavarësisht nga cila parti jeni. Dëshmoni se nuk jeni 20%, ashtu siç na trajtojnë me vite", u shprehë ndër të tjera kandidati për president, Reka.

Miqësia me fqinjët bart zhvillim ekonomik dhe stabilitet

Shkup, 2 prill - Kandidati për president i partive në pushtet, Stevo Pendarovski, në fjalimin me video drejtuar qytetarëve e komentoi rëndësinë e vizitës së djeshme të kryeministrit së Republikës së Greqisë, Aleksis Cipras dhe ndërtimin e miqësisë. Pendarovski konsideron se vizita është me rëndësi historike, se kontribuon për stabilitet në rajon dhe zhvillim të shpejtë ekonomik për vendin tonë. "Vizita e kryeministrit Cipras me delegacionin e 70 kompanive është me rëndësi historike për vendin tonë. Miqësinë e re që e ndërtojmë midis të dyja vendeve, jo vetëm që i stabilizon marrëdhëniet në Ballkan, por mundëson zhvillim të shpejt ekonomik në vendin tonë. Sot treguam se vetëm me vullnet të fuqishëm, lidership dhe vizion mund të bëhen hapa të rëndësishëm përpara", thotë Pendarovski në video. Pendarovski thotë se dera drejt të ardhmes së sigurt është e hapur dhe se qytetarët më 21 prill kanë mundësi të zgjedhin se a do të vazhdojmë përpara drejt një jete më të mirë ose do ta mbyllim derën dhe të mbesim në vendin e njëjtë ku jemi ndalur me vite.

DESKOSKA PARA TAKIMIT TË RI PËR LIGJIN E PROKURORISË

PUSHTETI NUK HEQ DORË NGA PSP

Shkup, 2 prill - Ministrja e Drejtësisë, Renata Trenevska-Deskoska para raundit të djeshëm të negociatave për Ligjin për prokurorinë publike, me të cilin duhet të zgjidhet statusi i ardhshëm i Prokurorisë Speciale Publike, deklaroi se mund të pritet përparim nëse përfaqësuesit e VMRO-DPMNE-së janë të gatshëm t'i respektojnë rekomandimet e komunitetit ndërkombëtar, por nëse mbeten në qëndrimet e veta, atëherë nuk sheh shpresë se diçka e posaçme do të ndodhte.

Ajo në deklaratë për mediat, dhënë para konferencës "Angazhim i përbashkët për arritje më të mira në gjyqësi" edhe njëherë përsëriti se nuk dakordohet me atë se duhet të përfundojë misioni dhe puna e PSP-së, por se si shtet do të dërgojmë porosi serioze nëse mundësojmë funksionim të përhershëm të PSP-së. "Rekomandimet të cilat i morëm janë shumë të qarta dhe janë bërë publikisht se atë që do ta vlerësojë komuniteti ndërkombëtar, do ta vlerësojë si hap pozitiv, por edhe si vendosshmëri në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, është dërgimi i sinjalit se asnjë qeveri nuk duhet të frikësohet nga lufta kundër korrupsionit sepse secili lloj i veprimit të paligjshëm në suaza të cilës do qeveri duhet të jetë i ndëshkuar me organizim të prokurorisë publike e cila do t'i ndjekë kryesit e korrupsionit të lartë. Në ligjin tonë është vendosur si Prokurori speciale publike e cila do t'i ruajë kapacitetet dhe do t'i fitojë kompetencat dhe garancat e zgjeruara për veprimin e vet të ardhshëm", deklaroi Deskoska.

Ajo shtoi se do të bëjnë përpjekje që të arrihet shumicë prej dy të tretave në Kuvend për votimin e këtij ligji. "Është çështje e grupeve të deputetëve dhe partive politike nëse do të duan t'u bashkangjiten proceseve eurointegruese apo prioritetin do ta vendosin në mbrojtjen e krimit në radhët e veta", deklaroi Deksoska. Edhe gjykatësja Margarita Caca Nikollovska konsideron se PSP duhet të vazhdojë të punojë në drejtim të përcaktimit të asaj çka ka qenë krim dhe të asaj çka nuk ka qenë krim. "Nuk mund të pranojmë situata deri dje materialet e përgjuara të jenë një nga dëshmitë, ndërsa tani përnjëherë të sjellim vendim që ato dëshmi duhet të lihen anash", deklaroi gjykatësja Caca Nikollovska. Posaçërisht është me rëndësi, sipas saj, cili do organ që do të veprojë, të implementohen standardet e procedurës së drejtë.

Vdes një grua në aksidentin e autostradën Tetovë-Gostivar

Tetovë, 2 prill - Në përplasjen e dy automjeteve në traun e pikës së pagesës në autostradën Tetovë-Gostivar dje në mëngjes, humbi jetën një grua 51-vjeçare nga Kërçova, informoi Sektori i Punëve të Brendshme në Tetovë. Aksidenti ka ndodhur rreth orës 06:45. "Në pikën e pagesës që është në afërsi të Tetovës midis dy kabinave ndodhi një aksident rrugor mes dy automjeteve. "Mercedes" me targa të Ohrit i drejtuar nga një grua 51-vjeçare, banore e Kërçovës dhe "Folsvagen Tuareg" me targa të Dibrës i drejtuar nga një 37-vjeçar, banor i qytetit.

Për shkak të përplasjes së dy automjeteve në vend jetën e ka humbur gruaja nga Kërçova e cila ka qenë vetëm në automjet", deklaroi Marjan Josifovski, zëdhënës i SPB-së Tetovë. Shoferi i automjetit tjetër, si dhe tre bashkudhëtarë prej 32, 36 dhe 62 vjet kanë marrë lëndime të ndryshme trupore dhe janë transferuar në spitalin e Klinikës së Tetovës. "Për shkak të seriozitetit të lëndimeve të gjithë janë mbajtur për mbikëqyrje në spital", tha Josifovski.

MEGJITHËSE ULET NUMRI I TË BURGOSURVE

TË PARËT NË EVROPË ME VDEKSHMËRI NË BURGJE

Maqedonia e Veriut është në mesin e vendeve me vdekshmëri më të lartë në burgje - 52.8 raste të vdekjes në 10.000 të burgosur, menjëherë pas Republikës së Moldavisë (55), para Bullgarisë (51.5), Portugalisë (51.3), Rusisë (51), Lituanisë (50), Azerbajxhanit (46.7), Kroacisë (43.9) dhe Britanisë së Madhe (39)

Koha — Omer XHAFERI

Strasburg, 2 prill - Sipas raportit për statistikën vjetore penale të Këshillit të Evropës për vitin 2018, të publikuar sot, Maqedonia e Veriut e ndjekë trendin evropian për ulje të shkallës së përgjithshme të të burgosurve. Përderisa në nivel të mbarë Evropës shkalla shënoi ulje për 6,6 për qind në periudhën mes viteve 2016 dhe 2018, duke u nisur prej 109.7 në 102.5 të burgosur në 100.000 banorë, Maqedonia e Veriut është në mesin e vendeve ku ajo shkallë më së shumti ka rënie - 9.7 për qind. Maqedonia e Veriut me 122.3 të burgosur për 100 vende, ndodhet në mesin e tetë vendeve të cilat kanë paraqitur problem të përgjithshëm serioz me stërngarkim në administratat e tyre të burgjeve. Pas Maqedonisë së Veriut pasojnë Rumania (120.5), Franca (116.3), Italia (115.0), Republika e Moldavisë (113.4), Serbia (109.2), Portugalia (105,9) dhe Çekia (105,6). Edhe katër vende kanë pasur dendësi në burgje mbi 100 të burgosur për 100 vende - Greqia (101.0), Austria (100.7), Sllovenia (100.5) dhe Danimarka (100.5).

Vendi ynë është në mesin e vendeve me proporcione më të ulëta të personave të paraburgosur, menjëherë pas Çekisë 8.2 për qind, Maqedonia e Veriut 8.4 për qind, Rumania 8.6, Lituania 9.3, Polonia 9.8 për qind, BeH: Republika Sërbska 11.2 për qind, Anglia dhe Uellsi (Britani e Madhe) 11.4, Bullgaria 12.5 për qind, Spanja (Katalonja) 14.3 për qind, Spanja (administrata shtetërore) 14.4 për qind dhe Gjeorgjia me 14.8 për qind. Në tërësi në Evropë të burgosurit ishin 22,4 për qind nga popullimi i përgjithshëm në burgje. Administrata të burgjeve me proporcione më të larta të personave të paraburgosur ishin Holanda 41.8 për qind, Danimarka 40.5, Zvicra 39.3 për qind, Armenia 36.7, Italia 34.5, Greqia 32.4 për qind, Irlanda Veriore (Britani e Madhe) 32 për qind dhe Franca 29.5 për qind, me përjashtim të vendeve me më pak se 300.000 banorë.

Administrata e burgjeve me popullim më të madh ishte Rusia me 602.176 të burgosur, Britania e Madhe (Anglia dhe Uellsi) me 84.373, Polonia 73.822, Franca me 69.596 dhe Gjermania me 64.193 të burgosur. Numri i të burgosurve më së shumti është ulur në raport me vitin paraprak në Rumani - për 17 për qind, Bullgari - 16.3, Norvegji - 10.1, Letoni 10.1 për qind, Maqedoni e Veriut për 9.5 për qind. Numri i të burgosurve më së shumti është rritur në Islandë +31.5 për qind, Danimarkë +7.2 për qind, Itali +7.2, Holandë +6.7 dhe Mal të Zi +5.5 për qind, ndërkaq përjashtohen vendet me më pak se 300.000 banorë. Maqedonia e Veriut është në mesin e vendeve me vdekshmëri më të lartë në burgje - 52.8 raste të vdekjes në 10.000 të burgosur, menjëherë pas Republikës së Moldavisë (55), para Bullgarisë (51.5), Portugalisë (51.3), Rusisë (51), Lituanisë (50), Azerbajxhanit (46.7), Kroacisë (43.9) dhe Britanisë së Madhe (Skocisë) (39). Përndryshe, shkalla e përgjithshme e vdekshmërisë në burgjet në Evropë në vitin 2017 paraqet 26.3 në 10.000 të burgosur. Shteti ynë është në vendet me gjatësi më të madhe të dënimeve me burg 20.4 muaj, përderisa mesatarja në Evropë është 8.2 muaj.

Shkup, 12 të lënduar në 16 aksidente

Shkup, 2 prill -Dymbëdhjetë persona kanë marrë lëndime të lehta trupore në nëntë prej gjithsej 16 aksidenteve të trafikut, ndërsa në shtatë është shkaktuar dëm material gjatë 24 orëve të fundit në rajonin e Qytetit të Shkupit. Sipas të dhënave të SPB Shkup, policia ka sanksionuar 39 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara dhe 20 shoferë para se të pajisen me patentë shoferi. Nga komunikacioni janë përjashtuar pesë shoferë fillestarë, një automjet me probleme teknike dhe 16 automjete të pa regjistruara. Për parkim jo të drejtë janë dhënë 125 masa, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë ngritur 84 automjete.

Janë dënuar edhe 12 këmbësorë të cilët e kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit të shënuar për këmbësorë, nëntë shoferë të cilët kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, një shofer i cili nuk u ka dhënë të drejtë kalimi këmbësorëve në vendkalimin e shënuar për këmbësorë, 10 për rreshtim jo të drejtë, 14 për mosshfrytëzimin e kaskës nga ana e drejtuese të biçikletave me motor, mopedëve dhe motoçikletave, shtatë për mosmbajtjen e rripit të sigurimit nga ana e shoferëve gjatë drejtimit të automjetit dhe 21 shoferë për shfrytëzimin e telefonit celular gjatë drejtimit të automjetit motorik.

"Taliri" shtyhet për më 16 prill

Shkup, 2 prill - Gjykimi për lëndën "Talir" të prokurorisë Speciale Publike në të cilën të akuzuar janë Nikolla Gruevski, Kiril Bozhinovski dhe Mile Janakieski të cilët ngarkohen për "keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar" dhe "larje parash", si dhe Ilia Dimovski dhe Leko RIstoski të akuzuar vetëm për veprën "larje parash" është shtyrë për më 16 prill. Për veprën e njëjtë, si subjekt juridik me aktakuzën është përfshirë edhe partia VMRO-DPMNE. Avokatët e të akuzuarve kërkuan nga gjykatësi Osman Shabani ta shtyjë seancën me arsyetimin se me PSP-në janë dakorduar t'u dorëzojnë CD me dëshmi verbale të dëshmitarëve sipas të cilave edhe do ta përgatisnin mbrojtjen. Në fillim të gjykimit të sotëm, prokurorja Lençe Ristovska kërkoi nga gjykata ta ndajë procedurën për të akuzuarin Nikolla Gruevski i cili ndodhet në arrati, me qëllim të, siç tha, zhvillimit të papenguar të procesit. Sipas aktakuzës, ata në mënyrë joligjore morën së paku 4,6 milionë euro për partinë, e më pas organizuan që paratë të paguhen në xhiro-llogari të partisë përmes fletëpagesave nga njerëz të ndryshëm.

Shekerinska fton fëmijët të mësojnë për luftërat

Shkup, 2 prill - Jemi të shqetësuar për konkursin e shpallur për ese lidhur me 70 vjetorin e formimit të Aleancës së Atlantikut të Veriut - NATO. Temat e konkursit që do të "sjellin më afër përfaqësimin, nocionin dhe rëndësinë e NATO-s" është se ne po promovojmë tema dhe ide ushtarake, dhe mosha e fëmijëve, veçanërisht ato më të vogla, është e diskutueshme për shkak se konkursi është menduar për fëmijët e moshës 4 deri në 17 vjeç. Kjo nuk është asgjë tjetër pos përpjekje për të manipuluar dhe indoktrinuar fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme në Maqedoni. Kështu thuhet në reagimin e Ambasadës së Parë të Fëmijëve "Megjashi", e cila ka dënuar konkursin e ministres së Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska drejtuar fëmijëve për esenë më të mirë për NATO-n. "Forma e konkursit është një mënyrë klasike për të shënuar një përvjetor nëpërmjet tregimeve, eseve dhe vizatimeve ku i jepet mundësia edhe për kritika, por konteksti pozitiv i dhënë për aleancën e NATO-s dhe festimi i përvjetorit është i dukshëm. Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë 'Megjashi' beson fuqishëm dhe përkrahë promovimin e paqes dhe transformimin jo të dhunshëm të konflikteve dhe gjithashtu beson se një botë pa aleanca ushtarake që promovon pushtetin, duke demonstruar forcën dhe frikën e mbjelljes, do të jetë më mirë e jetueshme. Ideja e mbrojtjes dhe promovimit të mbrojtjes si bazë për formimin e aleancave të tilla nuk e përjashton mundësinë e agresionit dhe sulmit duke shkaktuar viktima të



pafundme me viktima të shumta", thuhet në reagimin e Megjashit, ndërsa i ka bërë thirrjes ministres Shekerinska që ta tërheq konkursin drejtuar fëmijëve, pasi siç ceket, Kushtetuta dhe ligjet e vendit i mbrojnë fëmijët nga dhuna dhe traumat e luftërave, ndërsa keqpërdorimi i më të vegjëlve është vepër penale.

PROCESI GJYQËSOR PËR RASTIN "SAZDOVSKI"

KËRKESAT E AVOKATËVE NUK PËRFILLEN

Avokati Raufi tha se kryetarja e Trupit gjykues, Aleksovska, është e njëanshme dhe cenon parimin e mbrojtjes. "Ju nguteni që të jepni aktgjykimin sa më shpejt. Besoj se ju vuani pse nuk mund ti dënoni me burg të përjetshëm. Për këto veprime tuaja do të njoftohen të gjitha instancat në vend, dhe jashtë vendit, përfshi edhe Stejt Departmentin", tha avokati Raufi

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 2 prill - Në një atmosferë të tensionuar dhe me plotë përplasje, të martën filloi procesi gjyqësor për rastin "Sazdovski". Kjo situatë u krijua pasi që pala mbrojtëse kërkoi anulimin e seancës, me qëllim përgatitjen më të mirë të mbrojtjes. Arsyeja e këtij propozimi të avokatëve Naser Raufi dhe Asmir Alispahiq, ishte se ato e kishin angazhuar neuropsikiatrin Nikolla Sterjovski, si këshilltar teknik për parashtrimin e pyetjeve të kryqëzuara ndaj ekspertizës plotësuese e cila buroi nga rikonstruimi i ngjarjes.

"Ekspertizën e kam pranuar me datë 29 mars. Psikiatrin e kemi angazhuar me datë 1 prill. Për këto arsye kërkojmë që kjo seancë të anulohet, me qëllim që këshilltari teknik Nikolla Sterjovski të ketë kohë për ta shqyrtuar. Përveç ekspertizës, ai duhet ti shqyrtoj edhe shkresat e lëndës dhe të gjitha rrethanat", tha avokati Asmir Alispahiç. Kryesuesja e Trupit gjykues, Daniella Aleskovska-Stojanovska, tha se ekspertiza ka qenë gati me 27 mars dhe avokatët kanë qenë të njoftuar me kohë se atë mund ta marrin tek shërbimet përkatëse. Për shkak se bëhet fjalë për lëndë "paraburgimi", gjykatësja Stojanovska, nuk pranoi ta prolongoj seancën.

Ndaj kësaj qasje të Trupit gjykues, reagoi avokati Naser Raufi, i cili për të dytën herë gjatë këtij procesi gjyqësor kërkoi përjashtimin e gjykatëses Daniella Aleksovska – Stojanovska, nga gjykimi i mëtutjeshëm i rastit. Duke e arsyetuar këtë kërkesë, avokati Raufi, tha se kryetarja e Trupit gjykues, Aleksovska, është e njëanshme dhe cenon parimin e mbrojtjes.

"Pa nevojë na jepni trysni, duke mos i lejuar këshilltarit teknik (neuro-psikiatrit) të angazhuar nga ana jonë të ketë mjaftueshëm kohë për ta shqyrtuar ekspertizën e fundit psikiatrit dhe të gjitha shkresat e lëndës. Ndërkohë, të gjitha palët tjera në proces kanë pasur mjaftueshëm kohë për ta analizojnë lëndën dhe të japin mendimin. Ne gjatë gjithë kohës kemi qenë të rregullt në gjykim. Kërkesa jonë për prolongim të gjykimit, minimum për një ditë është që këshilltari teknik ta shqyrtoj lëndën. Mirëpo, unë besoj se ju nguteni që të jepni aktgjykimin sa më shpejt. Besoj se ju vuani pse nuk mund ti dënoni me burg të përjetshëm. Për këto veprime tuaja do të njoftohen të gjitha instancat në vend, dhe jashtë vendit, përfshi edhe Stejt Departmentin", tha avokati Raufi.

Ndryshe, siç mëson gazeta KOHA, ekspertiza e fundit e realizuara nga psikiatria Sllavica Arsova, është në kundërshtim me rrëfimet dhe deklarata e të akuzuarve, në pjesën e kohëzgjatjes së përleshjes mes të ndjerit Nikolla Sazdovski dhe të akuzuarve Besir Bela e Skender Demiri.

DEPUTETI BOGOEVSKI DHA UDHËZIME SI TË KRYHET HETIMI!

Deputeti i koalicionit të LSDM-së, Pavle Bogevski, gjatë debatit në emisionin Klik Plus në TV 21, ku përballë kishte Vladimir Nelloskin nga VMRO-DPMNE, u lavdërua se gjatë kohës kur kishte ndodhur ngjarja me të ndjerin Nikolla Sazdovski, ai përmes rrjetit social Fejsbuk kishte reaguar dhe udhëzuar se si duhet trajtuar e gjithë ngjarja."Kur ishte 'rasti Sazdov', unë isha ndër të parët i cili që thashë se kualifikimi për dhunë si vepër ndoshta është pak nënçmues. Atëherë në ato momente ende nuk kishte pasojë vdekja dhe kuptohet se nuk mundej të cilësohej si vrasje. Por, kishte çështje që duhej shqyrtuar, si formë e kualifikuar e kështu me radhë. Isha ndër më të zëshmit në Fejsbuk, ku jepsha kritika dhe mendime për atë se si duhet dhe si mundet të udhëhiqet hetimi, respektivisht cila do të ishin hapat e institucioneve", thotë deputeti Bogoevski.

Kompanitë çeke duan të investojnë në Shkup

Shkup, 2 prill - Një numër i madh i kompanive çeke tregojnë interes të investojnë në Shkup. Kjo është një pikënisje dhe mundësi e mirë për ndërtimin e partneritetit të ri strategjik në pjesën e vendimeve për transport dhe infrastrukturë transportuese, menaxhim me mbeturinat, menaxhim me resurset e ujërave, teknologjitë mbrojtëse ekologjike dhe të ngjashme. Këtë dje e theksoi kryetari i Shkupit Petre Shilegov në forumin e biznesit midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Çekisë. "Mbrojtja e mjedisit të jetesës për Republikën e Maqedonisë së veriut, ndërsa veçanërisht për Qytetin e Shkupit, paraqet një fushë të madhe ku ekzistojnë shumë mundësi të hapura për bashkëpunim. Më gëzon fakti se një numër i madh i kompanive çeke tregojnë interes të investojnë në Shkup, Kjo është një pikënisje dhe mundësi e mirë për ndërtimin e partneriteteve të reja strategjike në pjesën e zgjidhjen për transportin dhe infrastrukturën transportuese, menaxhimit me mbeturinat, menaxhimin me resurset e ujërave, teknologjitë mbrojtëse ekologjike dhe të ngjashme", tha Shilegov. Shtoi se ai dhe administrata e qytetit janë në dispozicion për të gjitha kompanitë e interesuara. Sipas tij, në pjesën punuese në këtë forum do të hapen mundësi të reja për të gjithë.

ELEM-i VJET KA FITUAR RRETH 30 MILIONË EURO

Shkup, 2 prill - SHA ELEM e ka përmbyllur vitin e kaluar me fitim prej 29.827.097 euro, që, sipas kumtesës së kompanisë, ka të bëjë, para së gjithash, në punën e tyre efikase dhe shitjeve të kryera dhe të sinkronizuara me sukses të tepricave të energjisë elektrike me çmim mesatar për rreth 50 për qind më të lartë nga çmimi i rregullt i energjisë elektrike.

"Në vitin 2018 SHA ELEM ka realizuar të ardhura prej 21.051.753 euro nga shitja e tepricave të energjisë elektrike. Në këtë rast, janë shitur gjithsej 353.320 MWh energji, me çmim mesatar prej 59,58 euro për MWh, kumtoi ELEM-i, duke potencuar se 2018-ta është viti më i suksesshëm financiar nga ekzistimi i kompanisë. Edhe pse për shkak të riparimeve të të gjitha kapaciteteve janë rritur shpenzimet për pjesët dhe materialet rezervë dhe shërbimet për mirëmbajtje, thekson kompania, megjithatë janë realizuar kursime të konsiderueshme sipas pozicioneve të tjera, siç janë shpenzimet për mazut, shpenzimet për lëndët e para dhe materialet, shpenzimet e tjera nga puna…Vitin e kaluari kanë ulur shpenzimet për gërmimin e thëngjillit dhe qymyrit, si dhe për angazhimin e mekanizmit të jashtëm, prej 38 milionë euro në vitin 2015 në gjashtë milionë euro në vitin 2018. Kursime të mëdha, shtojnë nga ELEMI-i, vërehen edhe në konsumimin e mazutit në REK Bitola lidhur me vitet paraprake, si në sasitë e përgjithshme, ashtu edhe në konsumimin specifik të mazutit sipas KWh të prodhuar energji elektrike. Ulja e shpenzimeve për mazut lëviz prej 17.800. 000 euro në vitin 2015 në katër milionë euro në vitin 2018.

Pas shumë viteve rritje, çmimi rregullator i energjisë elektrike vitin e kaluar është ulur prej 41 euro për MWh në 39,67 euro për MWh. ELEM-i thekson se pas rënies së vazhdueshme të prodhimit në dekadën e fundit, vërehet rritje e butë e prodhimit vitin e kaluar, i cili për sivjet është planifikuar të jetë më i madh dhe prodhimi i përgjithshëm të arrijë 4.400 GWh, gjegjësisht 10 për qind më shumë se në vitin 2017. "Më 17 qershor të vitit të kaluar kur të dyja vendet tona e nënshkruan Marrëveshjen e Prespës shkruajmë histori disa herë. Greqia është vendi i parë që e ka nënshkruar Protokollin për anëtarësim në NATO, që është dynim i ynë strategjik, ndërsa kryeministri Aleksis Cipras i bëri thirrje BE-së të fillojë negociata për anëtarësimin e shtetit tonë. E gjithë kjo është për fitore të politikës së përparimit, për paqe dhe miqësi midis popujve", tha Zaevi në takimin me Ciprasin.

Theksoi se verdikti politik, miqësia dhe besimi i ndërtuar muajve të kaluar, na kanë sjellë deri në seancën e sotme të Këshillit të Lartë për Bashkëpunim midis të dyja vendeve, ku e nënshkruan Planin Veprues për përforcimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës konform Marrëveshjes së Prespës.

SHËNOHET DITA BOTËRORE E AUTIZMIT

MË SHUMË VËMENDJE PËR 20 MIJË PERSONAT AUTIK

Dita Botërore e Autizmit është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2007, si ditë në të cilën duhet t'u kushtohet vëmendje nevojave urgjente të personave me autizëm në mbarë botën. Supozohet se shtatë milionë njerëz në BE kanë spektër autik të çrregullimeve. Shumë prej tyre përballen me diskriminim dhe janë u nënshtrohen përjashtimit social

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 2 prill - Vlerësohet se mes 15.000 dhe 20.000 persona në vend kanë spektër autik të çrregullimeve, tregojnë studimet epidemiologjike të Shoqatës shkencore për autizëm në Maqedoninë e Veriut (SHSHMVA), e cila me asociacionin ndërkombëtar "Autizëm Evropa", iu bashkangjit fushatës për shënimin e 2 prillit, Ditës Botërore të Autizmit. Nga SHSHMVA informojnë se këtë ditë e shënojnë prej vitit 2011 dhe se i kanë përkthyer në gjuhën maqedonase materialet e asociacionit, të cilat janë të kapshme në ueb faqen e tyre. Veglat për fushatën mund të merren nga linku i ardhshëm "Që t'u përgjigjet sfidave të përditshme me të cilat përballen personat me autizëm, 'Autizëm Evropa' e filloi fushatën e titulluar 'Dinamikë e re për autizmin'. Autizmi është gjendje e përjetshme edhe në të gjitha vendet anëtare të BE-së, por edhe jashtë saj, personat me spektër autik të çrregullimeve përballen me sfida të ngjashme, siç janë: diagnoza me kohë, arsimimi, shërbimet shëndetësore, banimi dhe mbështetja jetësore nga ana e komunitetit. Nevojitet edhe qasje holistike për nevojat e këtyre personave, të cilën anëtarët e SHSHAMV çdo ditë e zbatojnë në aktivitetet dhe projektet tona", thekson kryetari i SHSHAMV, prof.dr. Vladimir Trajkovski. Video zyrtare për fushatën, tha ai, është krijuar nga "Autizëm Spanja", anëtare e "Autizëm Evropa". Qëllimi është inkluzion më i mirë social i personave me autizëm. "Autizëm Evropa" e publikoi veglën për fushatën, që i sqaron qëllimet e fushatës dhe përfshin materiale dhe strategji në mbi 14 gjuhë, si dhe në format të lehtë për lexim. Dita Botërore e Autizmit është shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2007, si ditë në të cilën duhet t'u kushtohet vëmendje nevojave urgjente të personave me autizëm në mbarë botën. Supozohet se shtatë milionë njerëz në BE kanë spektër autik të çrregullimeve. Shumë prej tyre përballen me diskriminim dhe janë u nënshtrohen përjashtimit social.

Shoqata shkencore e Maqedonisë së Veriut për autizëm është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse shkencore, qëllimet e së cilës janë zbulimi i shkaqeve të ASN, diagnozë e hershme dhe intervenim i hershëm, mbështetja e të drejtave të personave me autizëm dhe familjeve të tyre dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së tyre në përgjithësi.

KUMANOVË, VETËM 13 FËMIJË ME AUTIZËM E NDJEKIN MËSIMIN NË INSTITUCIONE

Shtatë fëmijë me autizëm e ndjekin mësimin në paralele të veçanta në shkollën fillore "Vëllezërit Milladinovci" në Kumanovë, informuan kompetentët nga shkolla. Në Qendrën Ditore për Personat me Aftësi të Kufizuar që funksionon nën Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, ka gjashtë fëmijë me autizëm. Dhe në dy institucionet fëmijët ndjekin mësimin dhe programin në përputhje me moshën së bashku me fëmijët me aftësi të kufizuara në zhvillim. "Në të kaluarën në përgjithësi nuk kishte fëmijë të regjistruar me autizëm ose shumë rrallë kanë qenë të regjistruar fëmijë me autizëm. Nuk kemi të dhëna sa fëmijë të sëmurë nga autizmi ka në Kumanovë, për shkak se në nivel të Maqedonisë nuk ka regjistër", deklaroi defektologia e shkollës, Milena Iliq Peshiq. Udhëheqësi i Qendrës Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar nën MPPS-n, Ivica Blagojeviq sqaroi se punojnë sipas programit dhe se këta fëmijë punojnë së bashku me fëmijë të tjerë me aftësi të kufizuara në zhvillim. Profesionistët potencojnë se është e nevojshme që të formohet qendër e veçantë për fëmijë dhe persona me autizëm, ku do të zbatoheshin praktikat dhe metodat që realizohen në shtetet e Evropës perëndimore.

TETOVA SHËNON DITËN BOTËRORE TË AUTIZMIT

Shkollat e Tetovës kanë nevojë për më shumë defektologë

Tetovë, 2 prill - Defektologët dhe psikologët, që janë kyçur në punë mësim me fëmijët me nevoja të veçanta përmes projektit të bëhen pjesë e shkollave në Tetovë si të punësuar të përhershëm. Këtë dëshiron ta arrijë pushteti lokal me mbështetje të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, sepse praktika ka treguar se në paralelet me nevoja të veçanta ka efekt të madh tek nxënësit para se gjithash me autizëm.

"Përmes projektit të Komunës së Tetovës dhe programit të UNDP-së për zhvillim pranë Kombeve të Bashkuara tre vite punojmë pilot projekt dhe raportet flasin se efekti është i madh. Do të insistojmë që të zyrtarizohet puna e këtyre 20 psikologëve dhe defektologëve dhe të jenë pjesë e katër shkollave si të punësuar, ndërsa ne përmes projektit të përfshijmë shkolla tjera", deklaroi kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi. Ajo theksoi se motoja e këtij projekti nga ky vit është "Ta bëjmë autizmin të flasë, të ketë zë të vetin".

"Synimi i të gjitha shkollave është që të kenë zhvillim inkluziv fëmijëror. Duhet të paralajmëroj mbështetje serioze ndërkombëtare për fillim të Qendrës për trajtim të fëmijëve me autizëm. Trajtimi i fëmijëve me autizëm të moshës më të vogël gjithnjë e më shumë jep mundësi për trajtim më efikas të gjendjes", tha Arifi. Me rastin e 2 prillit Dita botërore kushtuar informimit dhe aktivizimit për autizëm, kryetarja e Tetovës i vizitoi shkollat "Naim Frashëri" dhe "Vëllezërit Migjeni" ku janë angazhuar një pjesë e defektologëve dhe psikologëve. Në

projekt janë përfshirë edhe shkollat "Rexhep Voka" në Shipkovica dhe "Istigball" në Tetovë. *(U.H)*

Tre padi për kontrabandim me emigrantë

Shkup, 2 prill - Pas një procedure hetimore ndërkombëtare, prokurori kompetent i Prokurorisë Publike Themelore për përndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit në Gjykatën Themelore Shkup 1 - Shkup shtroi aktakuzë kundër tre personave, shtetas të Maqedonisë. Personat ngarkohen se kanë kryer vepër penale "Organizimin e një grupi dhe nxitjen e zbatimit të veprave tregti me njerëz, tregti me fëmijë dhe kontrabandimin e emigrantëve" dhe vepër të vazhduar penale "Kontrabandimin e emigrantëve". Siç kumtoi Prokuroria Publike Themelore, në periudhën nga qershori 2016 deri në gusht 2018 i dyshuari i parë, si organizator i grupit kriminel së bashku me shtetas të tjerë të Maqedonisë dhe të huaj, ka siguruar dokumente të falsifikuara të emigrantëve potencial të cilët nuk kanë mundur të marrin viza të rregullta për SHBA-në dhe Kanadanë. Ai për përfitime, duke bërë dokumente të rrejshme për udhëtim, në mënyrë ilegale ka bartur emigrantë përmes kufirit tonë shtetëror dhe përmes një rute të dakorduar paraprakisht i ka dërguar në Guatemalë, Meksikë, Kostarikë që të munden prej atje përmes vendkalimit ilegal - kufirit të ashtuquajtur të gjelbër nga Meksika të mbërrijnë në vendet e destinacionit përfundimtar - SHBA dhe Kanada. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, i dyshuari i parë së bashku me dy të dyshuarit e tjerë si pjesë e një grupi ndërkombëtar kriminel i përbërë prej personave nga Shqipëria, Spanja dhe shtete të tjera, nga lakmia kanë krijuar dhe organizuar grup për kontrabandimin e emigrantëve. Gjatë vitit 2017 dhe gjysmës së parë të vitit 2018, grupi pasi fillimisht do të realizonte takim të drejtpërdrejtë me emigrantët potencial - shtetas shqiptarë dhe tanë, ka bërë rekrutimin e tyre me ç'rast u ka organizuar udhëtim të plotë prej vendeve amë, përmes vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Republikës Dominikane, deri tek vendet e destinacionit final SHBA dhe Kanada. Grupi ka siguruar dokumente të falsifikuara për emigrantë potencial, ka rezervuar dhe blerë bileta për autobusë dhe transport me aeroplan, ka rezervuar dhe paguar akomodim të përkohshëm të emigrantëve në hotele/motele dhe hostele në vendet e kësaj rute. Për veprimet e ndërmarra, organizatorët e grupit kriminel kanë marrë pagesa në të holla prej emigrantëve në shumë prej 20.000 deri në 25.000 dollarë për një emigrant. Të dyshuarit si organizatorë të grupit kriminel e kanë planifikuar numrin e emigrantëve ilegal, zakonisht nga dy deri në katër persona, të cilët është dashur të kontrabandohen, e kanë dakorduar periudhën kohore dhe rutën nëpër të cilën do të realizohet kontrabandimi i emigrantëve përkohësisht do të qëndrojnë. E kanë dakorduar mënyrën e sigurimit të garancisë dhe pagesën e shumës së dakorduar pas arritjes së emigrantëve në vendet e destinacionit final.

Fillimi i fundit të epokës Erdogan?

Nga
Erkan ARIKAN

Si refren e ka përsëritur presidenti Recep Tayyip Erdogan një fjali gjatë daljeve në fushatën zgjedhore: Nëse AKP humb në qytetet kryesore, kjo do të sillte kaos në vend. Pas zgjedhjeve lokale në Turqi, duket se bëhet fjalë për më shumë se kaq: Bëhet fjalë për mbijetesën politike të presidentit turk! Sepse këto votime ishin një nga dështimet më të mëdha të presidentit të mësuar prej kohësh me suksesin. AKP humbi në qytete të rëndësishme. Që në natën e të dielës zgjedhore po qartësohej, se postet e kryetarëve të bashkive të qyteteve bregdetare, Izmir, Aydin, Antalya, Adana dhe Mersin do t'i kalonin partisë opoziatre demokratike, CHP. Por pas kësaj erdhi edhe një goditje tjetër për Erdoganin: Pas 25 vitesh të sundimit konservator islam në Ankara shenjohet papritur ndryshimi. Postin e kryetarit të bashkisë do ta marrë për 5 vitet e ardhshme sfiduesi republikan, Mansur Yavas. Kritikët thonë, se Erdogan nuk ia ka dalë t'i manipulojë në atë mënyrë që AKP ta mbante Ankaranë.

"NUK DO TË FLEMË NË 48 ORËT E ARDHSHME"

Me interes pritet Stambolli: E gjithë Turqia ndiqte betejën kokë më kokë të kandidatëve të CHP-së dhe AKP-së. Por papritur gjithçka u mbyll, komisioni zgjedhor nuk dha më rezultate. Kur ish-kryeministri turk, Binali Yildirim pohoi fitoren në mesnatë, e pastaj nuk doli më publikisht, shumë turq filluan të dyshojnë. Shpejt u përhapën zëra, se janë manipuluar votat për Stambollin, për të arritur një fitore të AKP-së. "Ne nuk do të flemë në 48 orët e ardhshme", bëri të ditur kreu i CHP-së, Kilicdaroglu në një konferencë për shtyp. Tani ekziston frika, që fitorja e kandidatit të CHP, Ekrem Imamoglu në Stamboll ndoshta i ka ikur nga dora e partisë CHP për shkak të manipulimit. Një sinjal për këtë mund të jetë edhe bllokimi i publikimit të rezultateve nga Komisioni i Lartë Zgjedhor për Stambollin. Por nuk e pengoi kreun e CHP-së të pohonte në një konferencë për shtyp në orët e mëngjesit, se shumica e votave të numëruara janë për Imamoglu. E sigurt duket se nëse vërtet Stambolli i kalon AKP-së, mund të përballemi me protesta, përleshje në rrugë deri edhe mësymjen e pallatit presicencial, gjithçka është e mundur, thonë vëzhguesit në terren. Ata pohuan se zgjedhjet nuk janë zhvilluar të lira, pohim i mbështetur edhe nga vëzhgues zgjedhorë të pavarur nga Europa.

PRESIDENTI I JEP FUND KRIZËS EKONOMIKE

Megjithatë CHP megjithë sukseset nuk duhet të gëzohet kaq herët: Erdogani nuk do të lerë gjë pa bërë, që të pengojë kryebashkiakët e rinj. Edhe pse ai tani paraqitet reflektues dhe pohon, se qeveria do të mësojë nga gabimet e bëra, nuk dihet se cili do të jetë hapi tjetër i Erdoganit. Opozita ka frikë se sidomos në Lindje dhe Juglindje të Anadollit, aty ku partia prokurde, HDP fitoi shumë komuna, mund të ndodhë që ato të vendosen në administrim të detyruar me njerëz të AKP-së. Një mjet i përdorur nga Erdogani në të shkuarën për t'ua mbyllur gojën politikanëve të padashur për të. Po ashtu javën e kaluar presidenti Erdogan bëri të ditur, se kriza ekonomike merr fund më 1 Prill. Ekspertë të bursës menduan një shaka të 1 prillit të bërë para kohe: Nëse Erdogani i zgjidhka kaq shpejt problemet ekonomike, pse pret atëherë zgjedhjet lokale?

> **Në Stamboll nuk ka rezultat zyrtar, por në qytete të rëndësishme, partia konservatore islame, AKP ka përjetuar humbje të fortë. Kjo ngre edhe çështjen e të ardhmes së presidentit**

EDHE SA KOHË DO TË QËNDROJË ERDOGAN NË PALLAT?

Një nga pyetjet më të rëndësishme pas kësaj shuplake zgjedhore për Erdoganin është, nëse ai do të qëndrojë në pallatin presidencial deri në fund të mandatit. Sepse edhe varianti tjetër është i mundur, që ai të përcaktojë një pasues që para fundit të mandatit të tij. I mundur është po ashtu edhe krijimi i një lëvizjeje të re konservatore-islamike. Prej kohësh flitet, edhe në radhët e politikanëve të moderuar, se ish-bashkudhëtarë të Erdoganit duan të krijojnë një parti të re.

Nëse ata e ndërmarrin këtë hap është e mundur, që deputetë të AKP-së i refuzojnë Erdoganit rreshtimin krah tij, dhe kalojnë tek lëvizja e re - një praktikë e njohur mes politikanëve në Turqi. Rezultati më vendimtar i këtyre zgjedhjeve megjithatë është: Presidenti Erdogan nuk u forcua në fund të tyre, përkundrazi: Imazhi tij brenda Turqisë, e sidomos brenda përkrahësve të tij ka pësuar goditje të fortë. *(DW)*

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë, 2 prill 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

NATO në epokën e Putinit dhe Trumpit

Nga
David REYNOLD

Më 4 prill 2019, NATO kremton ditëlindjen e saj të 70-të. Megjithatë, komandanti i saj i parë suprem, Duajt Ajzenhauer, shpresonte që aleanca të mos i kalonte vitet 1950. "Nëse për 10 vitet e ardhshme"- i tha një miku të tij në shkurtin e vitit 1951, "të gjitha trupat amerikane të stacionuara në Evropë për qëllimin e mbrojtjes së kombeve atje, nuk do të jenë rikthyer në SHBA, atëherë ky projekt do të ketë dështuar!". Ajzenhauer këmbënguli se SHBA-ja "nuk mund të jetë një Romë moderne, që ruan i kufijtë me legjionet e saj". Filozofia e tij ishte e ngjashme me atë të Pol Hofmanit, administratorit amerikan të Planit Marshall që thoshte:"Ta bëjmë Evropën të ecë me këmbët e saj!".

Pse atëherë, ka qenë kaq e vështirë që Evropa të qëndrojë mbi këmbët e veta? Dhe pse Amerika, ka zgjedhur të mbajë Evropën mbi shpinën e vet gjithë kësaj kohe? Me NATO-n tashmë në moshën e pensionit, vlen të gjurmohet evolucioni i aleancës gjatë Luftës së Ftohtë, dhe pas rënies së Bashkimit Sovjetik. E gjitha nisi si një traktat, dhe jo si një aleancë. Ky dallim, shpesh i injoruar, është i rëndësishëm. Administrata Truman, shpresonte që ndihma e Planit Marshall, do të rikthente prosperitetin dhe vetëbesimin e Evropës Perëndimore përballë kërcënimit komunist, si nga Bashkimi Sovjetik, ashtu edhe nga partitë komuniste perëndimore, veçanërisht në Italì dhe Francë.

Nënshkrimi i Traktatit të Atlantikut të Veriut, ishte në fakt një revolucion në politikën e jashtme të SHBA-së. Ajo reflektoi jo vetëm gjendjen alarmante të marrëdhënieve sovjetiko-amerikane në vitet 1948-1949, por edhe ndryshimin e mendësisë zyrtare amerikane. Kapitullimi i Francës dhe sulmi ndaj Pearl Harbor, i bindi politikëbërësit amerikanë, se në epokën e lindjes së fuqisë ajrore, Shtetet e Bashkuara nuk ishin më të sigurta pas barrierave të tyre tradicionale oqeanike, dhe më në veçanti, se ajo duhet të luante një rol aktiv në punët e Evropës. 12 nënshkruesit origjinalë - Amerika, Kanadaja dhe 10 shtete të Europës Perëndimore - ranë dakord ta trajtonin një sulm ndaj njërit anëtar, si një sulm mbi të gjithë:parimi i sigurisë kolektive, i mishëruar në nenin 5 të Traktatit. Por secilit shtet, iu lejua ta "ndërmerrte një veprim të tillë, nëse e quan të nevojshme" respektimin e këtij detyrimi:pra nuk ishte një zotim automatik për të përdorur forcën.

Angazhimi i liderëve të NATO-s në vitin 2014, për të rritur shpenzimet e mbrojtjes kombëtare në 2 për qind të PBB brenda një dekade, është arritur deri më tani nga vetëm 7 nga 29 vendet anëtare, me Gjermaninë që është një nga pengesat kryesore. Ndoshta sfida më e madhe e NATO-s në dekadën e saj të tetë nuk është frenimi i rusëve, por mbajtja e amerikanëve në gjirin e aleancës

Ajo që ndihmoi për ta shndërruar Traktatin në një aleancë ushtarake, ishte Lufta e Koresë. Pushtimi i Koresë së Jugut nga Veriu në qershorin e vitit 1950, u njoh si diçka që Stalini duhet ta kishte autorizuar dhe mbështetur. Pati një frikë, se radhën mund ta kishte Evropa Perëndimore. Në atë kohë, SHBA-ja kishte në Evropë vetëm 2 divizione ushtarake. Pas një debati të madh politik gjatë dimrit të viteve 1950-51, Shtetet e Bashkuara vendosën të angazhojnë 4 divizione luftarake në Evropën Perëndimore, dhe të ngrenë një strukturë të përshtatshme komanduese nën një Komandant Suprem të Forcave Aleate të Europës - i cili do të ishte gjithmonë një amerikan. Në këmbim të këtij angazhimi të pashembullt, për paqen në Evropë dhe sigurinë e Evropës Perëndimore, administrata e Trumanit kërkoi që edhe aleatët të bënin diçka më shumë. Në veçanti, ajo kërkoi riarmatim të Gjermanisë Perëndimore, por kjo ishte një anatemë për francezet pas 3 luftërave të tmerrshme kundër gjermanëve në 80 vjet:1870, 1914 dhe 1939.

Debati mbi këtë çështje u zvarrit për 4 vjet, dhe u dëshmua si një moment vendimtar për marrëdhëniet transatlantike. Një mundësi ishte të zbatohej për mbrojtjen evropiane, logjika integruese e Planit Shuman të vitit 1950, që përfundimisht i hapi rrugën krijimit të Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut, dhe më pas Komunitetit Ekonomik Evropian (EEC), që u krijua më 1958. Por ideja një Komunitet Evropian i Mbrojtjes (EDC) u bllokua në vitin 1954 në Asamblenë Kombëtare të Francës, nga një aleancë mes golistëve dhe komunistëve. Në fund, riarmatimi i Gjermanisë Perëndimore vazhdoi me kushtin që forcat e saj të armatosura, të ishte tërësisht i dedikuar për NATO-n, në një kohë që eliminoi të gjitha armët e saj atomike, biologjike dhe kimike. Republika Federale, u pranua zyrtarisht në NATO në majin e vitit 1955. Sovjetikët u kundërpërgjigjën, duke formuar me satelitët e tyre Organizatën e Traktatit të Varshavës. Gjatë Luftës së Ftohtë NATO, përjetoi dy kriza të brendshme. E para u shkaktua nga presidenti francez Sharl de Gol.

Me synimin për të rindërtuar madhështinë e vendit pas disfatës poshtëruese të vitit 1940, ai sfidoi dominimin amerikano-britanik të aleancës, dhe kur u kritikua, e nxori gradualisht Francën nga komanda ushtarake e NATO-s. Dhe pastaj në marsin e 1966-ës, De Gol i kërkoi presidentit amerikan Lindon Xhonson që deri në prillin e 1967-ës, të gjitha trupat amerikane dhe ato të NATO-s, duhej të tërhiqeshin nga Franca. NATO e përfundoi tërheqjen brenda vitit, duke zhvendosur selinë e saj nga Versaja në Mons të Belgjikës. Kriza e re e brendshme e aleancës, u përqendrua më shumë në Republikën Federale të Gjermanisë. Nga fundi i viteve 1970, udhëheqësit e NATO-s kishin frikë nga vendosja e raketave të reja sovjetike me rreze të ndërmjetme SS-20 në Evropën Lindore.

Në kundërpërgjigje, udhëheqësit e NATO-s ranë dakord të vendosnin armë të reja të SHBA-së në Evropën Perëndimore. Vetëm 4 nga 12 anëtarët evropianë të aleancës, qenë të gatshme të pranonin raketat, kryesisht për shkak të protestave të brendshme. Opinioni gjerman ishte veçanërisht shumë i ndarë, dhe presionet e rrëzuan qeverinë e koalicionit të kancelarit Helmut Shmidt, arkitekti kryesor europian i "politikës së strategjisë së dyfishtë". U deshën dy liderë konservatorë të fortë - Helmut Kol në Gjermani dhe Margaret Theçër në Britani, që raketat të vendoseshin në këto 2 vende në vitin 1983. Zbatimi i suksesshëm i strategjisë së dyfishtë në fillim të viteve 1980, ndihmoi në ruajtjen e unitetit të NATO-s. Por, ç'mund të thuhet për prioritetin kryesor:frenimin e rusëve? Kur Pakti i Varshavës u shkatërrua, NATO foli për shndërrimin e vetvetes në më shumë se sa një "organizatë politike". Deklarata e saj në Londër në korrikun e 1990, foli për ndërtimin e "partneriteteve të reja, me të gjitha kombet e Evropës".

Në atë pikë, nuk kishte një debat publik rreth zgjerimit të NATO-s, përtej marrëveshjes që ish-Gjermania Lindore do të bëhej pjesë e zonës së NATO-s, sapo të inkorporohej në Republikën Federale. Gjatë negociatave të vështira rreth bashkimit gjerman, Gorbaçovi nuk arriti të këmbëngulte për ndonjë angazhim të detyrueshëm, sipas të cilit NATO nuk do të zgjerohej drejt lindjes. Pas kolapsit sovjetik, kjo çështje u bë urgjente gjatë presidencës së Bill Klintonit në SHBA. Por prioriteti i Departamentit të Shtetit dhe Pentagonit, ishte mbështetja e procesit të brishtë të reformave në Rusi, dhe ndihma për rizgjedhjen e Boris Jelcinit në vitin 1996.

Akti balancues i Uashingtonit, u pasqyrua në ofertën e statusit të Partneritetit për Paqe për anëtarët aspirantë në vitin 1994, dhe krijimin e një Këshilli të Përhershëm të Përbashkët midis NATO-s dhe Rusisë në vitin 1997. Por pranimi i Polonisë, Hungarisë dhe Republikës Çeke në 50 vjetorin e NATO-s në prillin e 1999-ës, u perceptua në Moskë, si një sfidë ndaj statusit të Rusisë si një fuqi e madhe. Edhe më e urryer për Kremlinin, ishte pranimi i 7 shteteve të tjera të Europës Lindore në vitin 2004, përfshirë Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë - të cilat ishin aneksuar me forcë në BRSS prej vitit 1940 deri në 1991. Vladimir Putin - pasardhësi i Jelcinit që nga viti 2000 - nuk bëri asnjë protestë të zëshme, dhe Rusia vazhdoi të merrte pjesë në aktivitete të ndryshme partnere me NATO-n, të tilla si stërvitjet e përbashkëta ushtarake. Në fakt, Putini po përpiqej të punonte ngushtë me Xhorxh Bushin në "Luftën kundër Terrorit", pas sulmeve të 11 shtatorit 2001.

Ai shpresonte të rindërtonte statusin e fuqisë së Moskës, dhe të siguronte një dorë të lirë pranë lagjes ruse. Nga 60 vjetori i saj në vitin 2009, NATO duket se e kishte fituar Luftën e Ftohtë, pa gjetur një rol të ri për veten. Dhe në vitin 2019, shumë komentues po pyesin nëse Lufta e Ftohtë u mbyll realisht apo jo, duke pasur parasysh konfrontimin në rritje me Rusinë e Putinit pas pushtimit prej tij të Krimesë dhe pjesëve të Ukrainës (partner i NATO-s); përpjekjet e tij të vazhdueshme për të destabilizuar shtetet baltike; dhe përdorimin e gjerë të sulmeve kibernetike, për të minuar proceset demokratike. Putin do të testojë versionin e përditësuar të kontrollit të aleancës, por gjithashtu kërkon një kapacitet të dyfishtë për dialog - në mënyrë që të përfitojë nga fakti që shoqëria ruse, nëse jo politika e saj, ka ndryshuar rrënjësisht nga Glasnosti i Gorbaçovit. Por mbijetesa e epokës së Trump, mund të jetë edhe më sfiduese.

Presidenti amerikan ka folur në mënyrë të përsëritur për largimin nga aleanca, dhe ditëlindja e 70-të e NATO-s në Uashington në muajin prill, është reduktuar qëllimisht në një ngjarje të ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare. Ndërkohë, thirrjet e nëntorit të vitit 2018 nga Emanuel Makron dhe Angela Merkel, për një ushtri evropiane si "një plotësues për NATO-n", janë pa ndonjë domethënie. Ata nuk arrijnë të trajtojnë si çështjen bërthamore, ashtu edhe atë gjermane. Angazhimi i liderëve të NATO-s në vitin 2014, për të rritur shpenzimet e mbrojtjes kombëtare në 2 për qind të PBB brenda një dekade, është arritur deri më tani nga vetëm 7 nga 29 vendet anëtare, me Gjermaninë që është një nga pengesat kryesore. Ndoshta sfida më e madhe e NATO-s në dekadën e saj të tetë nuk është frenimi i rusëve, por mbajtja e amerikanëve në gjirin e aleancës.

(Marrë me shkurtime nga "New Statesman")

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Pse duhet të hani mjaltë në mëngjes?

Ajo çfarë hani si të zgjoheni nga gjumi është tejet e rëndësishme për organizimin tuaj gjatë ditës. Niseni ditën mbarë dhe shëndetshëm me një lugë mjaltë në mëngjes. Mjekësia popullore e gjithashtu edhe mjaft studime të ndryshme vlerësojnë se nisja e ditës duke konsumuar një lugë të vogël me mjaltë është mënyra ideale për t'i dhënë fuqi dhe energji organizmit përgjatë gjithë ditës. Mjalta ka një përdorim të gjerë dhe jo vetëm si ëmbëltues. Përpara shpikjes së antibiotikëve, ajo përdorej gjerësisht për të trajtuar plagët apo djegiet e lëkurës. Gjithashtu është përdorur edhe për të zbutur kollën ose si maskë lëkure. Mjalti përmban sasi të vogla proteine, folati, vitamine C dhe vitamina të tjera të rëndësishme. Vlerat më domethënëse të mjaltës vijnë nga mineralet që përmban.

Nëna me tru të vdekur sjell në jetë foshnjën e saj

Po mbahet funerali i një nëne 26-vjeçare e cila solli në jetë djalin të enjten pavarësisht se i kishte vdekur truri qysh në muajin dhjetor. Sportistes Catarina Sequeira nuk i funksiononte truri pas një sulm të astmës akute në shtëpinë e saj. Foshnja, me emrin Salvador, ka ardhur në jetë kur ishte pothuajse 32 javë dhe tani është nën kujdesin e mjekëve, raporton BBC. Ky është rasti i dytë në Portugali që lind një nënë me tru të vdekur. Sportistja e njohur që e kishte përfaqësuar vendin në garat e kanosë, vuante prej astmës prej moshës së fëmijërisë. Ajo kishte pësuar sulm astme kur ishte në javën e nëntëmbëdhjetë të shtatzënisë dhe ishte në komë.

SODË BUKE PËR TRAJTIMIN E EKZEMËS

Ekzema është një problem i pakurueshëm por i trajtueshëm. Në këto trajtime përfshihen medikamente farmaceutike por edhe kurat natyrale. Një nga kurat më të mira natyrale përmban sodën e bukës

Soda e bukës është një përbërës që nuk mungon kurrë në kuzhinë apo në frigorifer. Përveç përdorimit tradicional, të paktë janë ata që e dinë se soda e bukës ka vlera terapeutike për të gjithë organizmin nga jashtë dhe brenda. Për shembull, pirja e ujit me sodë buke është një traditë e lashtë që rekomandohej kundër sëmundjeve si artriti, problemet me tretjen, urthi apo infeksionet.

Soda e bukës është shumë efikase kundër problemeve me lëkurën siç është ekzema. Ekzema është një pezmatim dhe inflamacion i lëkurës që shoqërohet me skuqje dhe kruarje të saj. Ekzema është një problem i pakurueshëm por i trajtueshëm. Në këto trajtime përfshihen medikamente farmaceutike por edhe kurat natyrale. Një nga kurat më të mira natyrale përmban sodën e bukës.

SI TË PËRDORNI SODËN E BUKËS KUNDËR EKZEMËS

Përdorimi më i mirë i sodës së bukës kundër ekzemës është duke e tretur atë në vaskë dhe më pas duke bërë banjë. Soda e bukës ka veti shumë qetësuese për lëkurën por lufton edhe bakteret që i kanosen asaj. Ekspertët sugjerojnë që të mbushni vaskën me ujë të ngrohtë dhe të hidhni çerek filxhan uji me sodë buke në të. Për maksimizimin e efekteve të sodës së bukës ndaj ekzemës ekspertët nënvizojnë rëndësinë e:

- Përdorimit të ujit të ngrohtë por jo të nxehtë,
- Trajtimit me butësi të lëkurës por jo fërkimit të saj,
- Përdorimit të një peshqiri të butë për lëkurën pas banjës.

Aplikoni një krem zbutës në të gjithë trupin rreth 3 minuta pas banjës dhe më pas pritjen për disa minuta të tjera që lëkura të përthithë kremin e më pas veshjen e rrobave.

PËRDORIMI I TËRSHËRËS KUNDËR TËRSHËRËS

Një kurë tjetër efikase kundër ekzemës ka të bëjë me tërshërën. Në rastin e saj ju mund të bëni banjë për 10-15 minuta duke hedhur në vaskë një filxhan me tërshërë. Por në vend të tërshërës mund të bëni banjë duke hedhur në vaskë 1 deri në 2 filxhanë çaji me uthull molle.

Efektet e kafesë, ndikon në mendime dhe sjellje

Mjafton të kujtosh kafenë që mendja të bëhet më vigjilente dhe e vëmendshme. Prandaj, një nga pijet më të konsumuara në botë gjithashtu ka një efekt psikologjik, sipas një studimi të ri të kryer nga Universiteti i Torontos të botuar në revistën shkencore "Consciousness and Cognition".

Studiuesit në fakt kanë vërejtur një efekt shkakësor, falë të cilit ekspozimi ndaj disa sinjaleve, edhe nëse është i vogël, mund të ndikojë në mendimet dhe sjelljet tona. Përmes katër studimeve të veçanta dhe duke përdorur një përzierje të pjesëmarrësve nga kulturat perëndimore dhe lindore, ata krahasuan efektet e mendimeve të kafesë dhe çajit. Studiuesit zbuluan se pjesëmarrësit e ekspozuar ndaj stimujve të lidhur me kafe e perceptuan kohën më të shkurtër dhe mendonin në kushte më konkrete dhe më të sakta, përcjell Atsh.

Efekti, megjithatë, nuk ishte aq i fortë në mesin e pjesëmarrësve që ishin rritur në kulturat lindore, të cilat sipas studiuesve janë më pak të dominuar nga konsumimi i kafesë.

Gjermanët thonë se kanë zbuluar substancën që lufton kancerin

Studiuesit kanë zbuluar në sipërfaqen e limfomave një kompleks proteinash që dëmton qelizat kanceroze. Përdorimi i saktë i mekanizmit në sipërfaqen e qelizave të kancerit, çon në vdekjen e tyre. Nuk është ende e qartë se përse qelizat e kancerit e kanë lënë të hapur këtë "derë". Megjithatë, studiuesit e Universitetit të Bonit dhe kolegët e tyre në kompaninë amerikane Caris Life Sciences kanë zbuluar çelësin e kësaj dere, të ashtuquajturin aptamer. I përdorur siç duhet, ai bëhet fatal për qelizat e kancerit.

Aptameret janë sekuenca të shkurtra të ADN-së që - varësisht nga radhitja e njësive ndërtimore gjenetike (nukleotide)- mund të kombinohen në forma të ndryshme. Günter Mayer, profesor i biologjisë kimike në Universitetin e Bonit dhe kolegët e tij kanë zbuluar pikërisht aptamerin e duhur, raporton DW. Studiuesit duan të studiojnë tani se përse qelizat kanceroze mbajnë mbi sipërfaqen e tyre proteina që shkatërrojnë vetë qelizën. Për këtë ka disa teori. Mayer thotë se kjo mund të vijë nga fakti që proteinat përdoren për të komunikuar me qelizat e tjera dhe për të përhapur tumorin. Derisa të qartësohet, se a mund të përdoren aptameret edhe në terapinë e trajtimit të tumorit, hulumtuesit do të kenë shumë për të bërë.

"Deri tani ne i kemi testuar aptamerët vetëm në laborator", thotë Meyer. "Por ne duhet të testojmë tani se a kanë efekt këto fragmente ADN-je edhe mbi limfomat në trupa me jetë". Pra, në vitet e ardhshme ata do ta testojnë substancën te minjtë. Veç kësaj, duhet të gjejnë edhe mënyrën e dhënies së medikamentit.

REKA PËR REPUBLIKËN
BLERIM REKA PËR PRESIDENT
VOTO
1
blerimreka.org
#EuReka

BERLINI KTHEN SYTË NGA TIRANA DHE PRISHTINA

Berlini zyrtar nis "të flasë", zërat kundër politikave të qeverisë shqiptare dhe problemit të korrupsionit, trafiqeve dhe pandëshkueshmërisë. A po mbështetet ideja e zgjedhjeve të reja? Krisjet politike menjëherë pas idesë së korrigjimit të kufijve Kosovë-Serbi dhe tentativës për imponimin e BE-së për të pranuar "pa kushte shtesë" Shqipërinë si vend kandidat për në BE. Si u kthye Rama nga "lider rajonal" në "problem" për politikat në Ballkan

Vizita e kancelares gjermane Angela Merkel në Tiranë, katër vjet më parë, u keqlexua nga kryeministri Edi Rama, që më shumë se një mundësi që rajoni të dalë nga kriza dhe të shohë rrugën e integrimit, e mori si mbështetje personale. Që nga ajo kohë dhe pak muaj në vijim, Rama pati disa vizita në Ballkan dhe Berlin, duke tentuar të marrë rolin e "liderit rajonal", një kostum që kurrsesi nuk i qëndroi, pasi vendi kaloi kriza të rënda të kanabizimit masiv, problemit të madh të korrupsionit, krizave të brendshme politike dhe problem me çështjen e zgjedhjeve.

POLITIKA E TIRANËS SHQETËSON BERLININ

Për më shumë, duket se politikat zyrtare të qeverisë së Shqipërisë tashmë është kthyer në problem për Berlinin zyrtar, që në fakt përfaqëson më shumë se veten, është zëri dominues edhe në BE. Profesor Martin Henze, Kryetar i komisionit të Transportit në Këshillin Ekonomik të CDU-së gjermane, tre ditë më parë u shpreh se zgjedhjet e reja në Shqipëri janë domosdoshmëri për vendin dhe ndërkombëtarët, transmeton gazeta MAPO e Tiranës.

"Qeveria socialiste e Ramës do të jetë një problem i madh për bashkësinë ndërkombëtare. Korrupsioni në Shqipëri në të gjithë sektorët e qeverisë socialiste, Shqipëria është një qendër për trafikimin e drogës, kriminalitetin e rritur, ekonominë e lartë informale, pastrimin e parave të aktiviteteve kriminale, papunësinë e lartë.....", shkruan Henze në një postim në rrjetin social "linkedIn", ku paraqet disa nga gjetjet kryesore të raportit të DASH mbi Narkotikët, publikuar së fundmi. "Zgjedhjet e reja janë të nevojshme në Shqipëri për sigurinë e familjeve shqiptare dhe komunitetit ndërkombëtar", përfundon ai. Mund të ngjajë mendimi personal i një politikani pjesë e partisë CDU të Angela Merkel, por ishin po këta përfaqësues që një vit më parë shprehën rezerva për qeverisjen Rama për sa i përket plotësimit të kritereve për të marrë anëtarësimin si vend kandidat për në BE. Tashmë një vit më pas, situata politike në vend është edhe më e rëndë, me opozitën shqiptare që ka djegur mandatet e deputetëve dhe nuk njeh institucionin e Parlamentit, ndërsa kërkon largimin e Edi Ramës, krijimin e një qeverie teknike dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Ky vendim ekstrem i opozitës u kritikua nga faktori ndërkombëtar, përfshi edhe ambasadën gjermane në Shqipëri, por zërat mbështetës nuk po mungojnë. Dhe sinjalet vijnë nga Berlini...

RAMA, "LIDER I VOGËL" PËR POLITIKË TË MADHE...

Kryeministri Rama dhe Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ishin nismëtarët e hedhjes në "treg" të idesë së korrigjimit të kufijve Kosovë-Serbi, gjashtë muaj më parë, që nënkuptonte kalimin e Mitrovicës së Veriut brenda kufirit të Serbisë dhe Kosova merrte Luginën e Preshevës. Për ta, ky ishte një opsion që do i jepte zgjidhje përfundimtare çështjes ku Serbia ta njihte Kosovën dhe njëkohësisht mbyllej një kapitull me mbi një shekull konflikt. I menjëhershëm ishte reagimi i kancelares gjermane Angela Merkel që në një vizitë në Kroaci e shprehu qartë se ishte kundër ndryshimit të kufijve në Ballkan, pasi kjo do sillte rrezikun e një konflikti zinxhir edhe në shtete të tjera. Pavarësisht deklaratës pa asnjë nënkuptim, kjo "lojë e madhe" nga dy liderë krejtësisht të vegjël do sillte të tjera qëndrime të së njëjtës linjë me Berlinin, këtë herë nga shtetet e tjera anëtare të BE-së. Gjithashtu, opozita zyrtare në Shqipëri (në atë kohë brenda institucioneve), e kundërshtoi idenë e korrigjimit të kufijve dhe i konsideroi qëndrimet e Ramës si të papranueshme. Gjithsesi, kryeministri shqiptar nuk e ka përmendur në ligjëratë të drejtë idenë e "korrigjimit të kufijve", por la të kuptohej se do ishte pro një zgjidhje që vinte nga të dyja palët, Kosova dhe Serbia, pavarësisht termit "korrigjim" apo shkëmbim territoresh. Rama me tej shkoi edhe në "kërcënime të ulëta" që më shumë entuziazmonin enturazhin e tij në Shqipëri se sa të "çudisnin" Berlinin apo Brukselin. Në një "patriotizëm rapsodik", Rama u shpreh se nëse BE nuk ofron Shqipërinë dhe Kosovën, atëherë ata kanë të drejtën që të bashkohen mes tyre; gjithashtu ngriti "alarmin" se BE duhet të ishte më dashamirëse me Shqipërinë, pasi Rusia, Kina apo Turqia ishin të gatshme të shtrinin ndikimin e tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nëse BE do qëndronte indiferente. Një mënyrë për të anashkaluar problematikat e vërteta, por këtë herë Bashkimi Europian, e veçanërisht Gjermania po i shohin me lupë problemet që po kalon vendi ynë. Katrin Staffler, përfaqësuese e CSU, raportuesja e re për Shqipërinë u shpreh se për të vendosur për hapjen ose jo të negociatave duhet pritur raporti i ri i Komisionit të BE-së për Shqipërinë. "BE-ja nuk është vetëm një treg i përbashkët ose një hapësirë e përbashkët ekonomike. Në radhë të parë ajo është një bashkësi vlerash bazë. Këto janë: shteti i së drejtës, lufta kundër korrupsionit, disa të drejta themelore që ua garantojmë njerëzve. Dhe unë mendoj se për sa kohë që nuk shohim përparime në këto drejtime, bëjmë mirë të mos flasim për afate kohore, të mos bëjmë asnjë premtim, por të shohim se cilat janë pikat që duhen përmbushur", – u shpreh Staffler për Deutsche Welle.

QEVERIA E SERBISË ANGAZHON LOBISTË AMERIKANË KUNDËR TAKSËS DOGANORE

Qeveria e Serbisë ka angazhuar një kompani lobuese me bazë në SHBA për ta përfaqësuar atë për një mosmarrëveshjeje aktuale me Kosovën në lidhje me taksat e tregtisë të vendosura nga Prishtina

Autoritetet serbe kanë nënshkruar një marrëveshje me kompaninë amerikane Cleary Gottlieb Steen & Hamilton LLP për të përfaqësuar Beogradin në mosmarrëveshjen e saj me Prishtinën në lidhje me taksën tregtare, sipas një kontrate të paraqitur në Njësinë e Regjistrimit të Agjentëve të Huaj (FARA), e cila është pjesë e Departamentit të Drejtësisë së SHBA.

"Jemi të kënaqur që Republika e Serbisë e ka angazhuar kompaninë tonë për ta përfaqësuar atë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me SHBA-së (duke përfshirë komunikimet vis-à-vis me Shtetet e Bashkuara të Amerikës) që janë shfaqur në lidhje me një mosmarrëveshje me rajonin e Kosovës dhe Metohisë (jashtë Serbisë, Kosova shpesh referohet si "Kosovë *") për çështje të caktuara të bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë kufizimet tregtare të vendosura nga autoritetet e Kosovës, në veçanti, ndaj mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga Serbia ("Angazhimi"), thotë kontrata të cilën Njësia e Regjistrimit FARA e ka pranuar më 28 mars.

Dokumenti i botuar nga Njësia e Regjistrimit FARA nuk e specifikon shumën që Serbia do ta paguajë për shërbimet e kompanisë amerikane. Qeveria e Kosovës fillimisht vendosi një taksë prej 10 përqind mbi importet e mallrave serbe më 6 nëntor të vitit të kaluar, duke e marrë si shkas "sjelljen negative" të Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës dhe fushatës së saj ndërkombëtare kundër njohjes së Kosovës. Megjithatë, me 21 nëntor, Kosova vendosi të rrisë taksën në 100 përqind, duke ngjallur kritika nga qeveritë perëndimore, përfshirë edhe zyrtarët e lartë të SHBA.

Kosova tashmë ka kontrata aktuale lobimi me kompanitë lobuese të SHBA.

Dy kontratat e fundit u nënshkruan nga Ministria e Jashtme e Kosovës dhe kompania amerikane Pillsbury Winthrop ShaW Pittman, LLP "me qëllim të ofrimit të këshillave ligjore dhe mbështetjes për marrëdhëniet qeveritare dhe aktivitetet e komunikimit publik".

Sipas Aktit të Regjistrimit të Agjentëve të Huaj të SHBA, agjentët që përfaqësojnë fuqitë e huaja në "kapacitet politik ose kuazi politik" duhet të zbulojnë detajet e marrëdhënieve të tyre.

BREXITI PA MARRËVESHJE GJITHNJË E MË I MUNDSHËM

Britania ka vendosur të largohet nga Bashkimi Evropian në një referendum të mbajtur në vitin 2016. Ekspertët kanë paralajmëruar se Brexiti pa marrëveshje me BE-në do të shkaktonte recesion në Britani dhe do të ngadalësonte rritjen ekonomike në bllokun evropian

Kryenegociatori i Bashkimit Evropian për Brexit, Michel Barnier, tha se ka më shumë gjasa që Britania të dalë nga BE-ja javën e ardhshme, pa një marrëveshje të negociuar me bllokun. "Brexiti pa marrëveshje nuk ka qenë kurrë skenari ynë i dëshiruar apo i synuar. Brexiti pa marrëveshje nuk ka qenë kurrë skenari im i dëshiruar apo i synuar. Por, 27 vendet e tjera të BE-së janë tani të përgatitura", tha Barnier. Ai bëri këto komente në Bruksel, një ditë pasi Parlamenti në Londër i refuzoi alternativat e mundshme të marrëveshjes për Brexit, të cilën kryeministrja britanike, Theresa May, e ka negociuar me Bashkimin Evropian.

Në votim ishin mocioni për të mbajtur Britaninë në bashkimin doganor me BE-në, mocioni për qëndrimin e Britanisë në tregun e BE-së për mallra dhe shërbime, mocioni që kërkonte hedhjen në referendum publik të çdo marrëveshjeje që Britania arrin me BE-në dhe mocioni për anulim të Brexitit. Të gjitha këto mocione u kundërshtuan. Marrëveshja e Mayt për Brexitin, apo daljen e Britanisë nga BE-ja, është refuzuar tri herë nga deputetët britanikë. May tani do të vendosë nëse do ta nxjerrë sërish marrëveshjen në Parlament, por Barnier përsëriti se BE-ja nuk do ta rinegociojë traktatin e arritur vitin e kaluar. "Nëse Mbretëria e Bashkuar do që të largohet nga BE-ja në mënyrë të rregullt, kjo marrëveshje, ky traktat është dhe do të jetë i vetmi", tha Barnier.

Ligjvënësit britanikë e kanë refuzuar marrëveshjen kryesisht për shkak të politikave në kufirin me Irlandën, që do të zbatoheshin pas Brexit-it. Si rezultat i dështimit të marrëveshjes së saj në Parlament, May është detyruar të kërkojë nga BE-ja të shtyjë datën e Brexitit, që fillimisht ka qenë e caktuar për 29 mars. Për rrjedhojë, Britania e Madhe, deri më 12 prill, duhet të vendosë nëse do të largohet nga BE-ja pa marrëveshje, ose nëse do të kërkojë zgjatje të afatit nga bloku. Barnier tha se çdo zgjatje e re e afatit ka "rreziqe të konsiderueshme për BE-në" dhe se bloku do të pajtohej vetëm nëse paraqitet një "justifikim i fortë". Në ndërkohë, Parlamenti britanik ka marrë kontrollin e Brexitit nga Qeveria, në mënyrë që të mbajë një seri votimesh për gjetjen e një alternative për marrëveshjen e Mayt.

Britania ka vendosur të largohet nga Bashkimi Evropian në një referendum të mbajtur në vitin 2016. Ekspertët kanë paralajmëruar se Brexiti pa marrëveshje me BE-në do të shkaktonte recesion në Britani dhe do të ngadalësonte rritjen ekonomike në bllokun evropian.

Publicitet

NATASHA KANDIQ I KAM PARË VETË KRIMET SERBE

Natasha Kandiq ka qenë një ndër të rrallët në Beograd që ka justifikuar ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999 dhe këtë e ka thënë hapur. Ajo më pas ka mbështetur edhe pavarësinë e Kosovës, të shpallur në shkurt të vitit 2008. Ishte mysafirja e vetme nga Serbia në Kuvend, në ceremoninë e shpalljes së pavarësisë

Kuvend, në ceremoninë e shpalljes së pavarësisë.

Zoran SOLUMUN

Aktivistja më e njohur serbe për të drejtat e njeriut, Natasha Kandiq, themeluese e Fondit për të Drejtën Humanitare, flet për bombardimet dhe luftën e Kosovës. Ajo ka qenë edhe vetë shpesh në Kosovë, në kohën e luftës. "Pak kohë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, pra me 25 mars në orët e para të mëngjesit, diku nga ora dy apo tre, ra zilja e telefonit", kujton Natasha Kandiq.

"Ishte Nekibe Kelmendi. Më tha se policia është futur në shtëpinë e tyre dhe ka marrë me vete burrin e saj Bajramin, një avokat shumë i njohur, dhe dy djemtë e tyre. Nuk e di çfarë të bëj. I them se është mirë që po punojnë linjat telefonike dhe nesër në mëngjes menjëherë duhet të shkojë në policë apo shërbimin sekret të shtetit dhe të kërkojë sqarime... Këtë bisedë nuk do ta harroj kurrë. Një ditë më pas kanë gjetur trupat e pajetë të Bajramit dhe dy djemve, pranë një pike të karburanteve, në dalje të Prishtinës. Policia thoshte se ka nisur hetimet. Por ky ishte vetëm maskim i një krimi, sepse këtu nuk ka pasur hetime, nuk ka pasur asgjë. Nekibe Kelmendi ka vdekur në vitin 2011 dhe kurrë nuk e ka kuptuar zyrtarisht se kush i ka vrarë burrin dhe dy djemtë e saj. Ka mbetur vetëm vajza e saj, e cila ende kërkon të vërtetën. Edhe ne në Fondin për të Drejtën Humanitare po kërkojmë të vërtetën, por pa sukses".

Natasha Kandiq ka qenë një ndër të rrallët në Beograd që ka justifikuar ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999 dhe këtë e ka thënë hapur. Ajo më pas ka mbështetur edhe pavarësinë e Kosovës, të shpallur në shkurt të vitit 2008. Ishte mysafirja e vetme nga Serbia në

THEMELIMI I FONDIT PËR TË DREJTËN HUMANITARE

"Fondi për Drejtën Humanitare është themeluar në vitin 1992", thotë Kandiq, "me qëllim dokumentimin e krimeve dhe shkeljen e të drejtave të njeriut në Serbi, atje ku jetojnë grupet etnike - shqiptarët në Kosovë dhe myslimanët në Sanxhak".

Natasha Kandiq ka diplomuar në vitet 70-të në Fakultetin filosofik në Beograd, në sociologji. Në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë ka punuar në Shoqatën e Sindikatave, ndërsa në vitet 80-ta ka qenë bashkautore e librit "Nyja e Kosovës", në të cilën kritikohen ashpër autoritetet serbe në Kosovë, për politikë dhune, pas ardhjes së Sllobodan Milloshevicit në pushtet. Pas botimit të këtij libri, Kandiq e ka ndërprerë punën në sindikatë dhe ka filluar hulumtimet e opinionit publik.

Në fund të vitit 1992 e ka themeluar Fondin për të Drejtën Humanitare. Gjatë luftërave të viteve 90-të, Fondi ka mbledhur të dhënat për krimet e luftës në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Këto dokumente kanë qenë më pas ndër dëshmitë kryesore në proceset e Tribunalin e Hagës për krime lufte në ish-Jugosllavi.

Natasha Kandiq ka marrë një numër të madh vlerësimesh ndërkombëtare për punën e saj. Në vitin 2003 ka qenë edhe në listën e 36 heronjve evropianë, të botuar në revistën "Time". Në vitin 2005 është shpallur qytetare nderi e Sarajevës dhe Person i Vitit në Bosnje-Hercegovinë, sipas revistës "Slobodna Bosna". Me 2013 është nderuar me çmimin Hrant Dink në Turqi, ndërsa kongresmenët amerikanë Eliot Engel dhe Roger Viker e kanë propozuar Natasha Kandiqi në vitin 2018 edhe për çmimin Nobel për paqen.

AKTIVE PREJ VITIT 1996

"Zyrën e parë në Prishtinë e kemi hapur në vitin 1996", thotë Kandiq. "Aty kanë punuar së bashku shqiptarë dhe serbë. Detyra e tyre ka qenë mbledhja e të dhënave për gjendjen. Gjatë vitit 1997 kemi mbledhur të dhëna për ftesat masive të njerëzve në të ashtuquajtura biseda informative në polici. Gjatë marrjes në pyetje, ka pasur kërcënime masive ndaj atyre që janë angazhuar për pavarësinë e Kosovës. Atyre u është thënë se ky është terrorizëm dhe u është mohuar e drejta që me mjete paqësore të angazhohen për idetë e tyre politike".

Kosova ishte lënë pasdore në kohën luftës në Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë. Lëvizja paqësore e shqiptarëve të Kosovës, në krye me Ibrahim Rugovën dhe Fehmi Aganin, ka ofruar rezistencë paqësore gati një dekadë të tërë. Ata kanë organizuar edhe sistemet paralele të pavarura në shkolla dhe shëndetësi. Sistemi paralel ka funksionuar me vite. Në vitin 1997, në skenë është paraqitur edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe situata ka ndryshuar radikalisht. Në vitin 1998 kanë filluar konfliktet e armatosura mes forcave serbe dhe UÇK. Bashkësia ndërkombëtare, e cila me vite të tëra kishte injoruar lëvizjen paqësore të rezistencës, tani përpiqej të ndalte luftën. Në vitin 1999 janë mbajtur edhe negociata në Rambuje të Francës, por pala serbe nuk e ka nënshkruar marrëveshjen paqësore.

FILLIMI I BOMBARDIMEVE

Pas dështimit të bisedimeve në

Rambuje, NATO filloi aksionin e bombardimeve me emrin "Operation Allied Force", me 24 mars 1999. "Ditën e tretë pas fillimit të bombardimeve jam nisur për Kosovë. Nuk e kam ditur se çfarë po ndodh me bashkëpunëtorët tanë në Prishtinë. Ka qenë problem të shkosh në Kosovë, sepse nuk ka pasur mjete transporti. Kam marrë një taksi nga Beogradi deri në Bujanovc. Por taksia fillimisht është dashur të sigurojë benzinë, sepse në ato kohëra nuk ka pasur mjaft. Në Bujanovc mbërritëm disi, por nuk dija si të shkoj deri në Prishtinë. E pyeta taksistin të më çojë deri atje. Ai kishte shumë frikë, por kur i thashë se atje ka vetëm forca serbe, ai pranoi. Zyra jonë ishte thyer, kompjuterët ishin plaçkitur. I kam gjetur bashkëpunëtorët tanë nëpër shtëpi, të gjithë ishin tepër të frikësuar dhe nuk e dinin çfarë të bëjnë. U kam propozuar të shkojmë së bashku në Maqedoni, por ky u dështua si një plan i keq dhe nuk u realizua. Në Prishtinë ishte tmerr, në rrugë nuk kishte më shqiptarë. Kur kam shkuar të kërkoj një bashkëpunëtore të Fondit, para godinës së saj ishin mbledhur shumë njerëz. Policia i nxirrte me dhunë nga godina dhe i urdhëronte të shkojnë në drejtim të stacionit hekurudhor, e pastaj në Shqipëri. Pas katër ditësh në Prishtinë, katër shqiptarë dhe unë, me një taksi, jemi nisur për në Beograd. Taksisti ishte një njeri i mirë, ai e shihte se çfarë po bëjnë me shqiptarët. Nuk fliste shumë. E pyeta a është i gatshëm të transportojë katër shqiptarë për në Beograd, sepse duhet të kalojmë kontrollet policore? Le ta provojmë, tha ai. Kontrollin e parë kaluam pa problem. Në pikën e dytë na ndalën. Unë heshta, ndërsa shoferi i taksisë e pyeti policin, ku mund të gjej karburante, sepse nuk kam asnjë pikë? Polici u përqendrua tek pyetja dhe nuk na kontrolloi fare. Kaluam".

ZGJATJA E LUFTËS

Strategët e NATO-s kishin planifikuar një luftë më të shpejtë. Ushtria dhe policia serbe nuk kanë bërë ndonjë rezistencë tepër të madhe ndaj bombardimeve të NATO-s, por janë fshehur mirë dhe kanë evituar humbjet e mëdha. Lufta u zgjat, ndërsa vuajtjet e popullit në Kosovë shtoheshin nga dita në ditë.

"Unë kam shkuar në Kosovë gati çdo dhjetë ditë", kujton Natasha Kandiq. "Gjithmonë me të njëjtin taksist, i cili mësoi rrugën dhe njihte njerëzit në rrugë. Kam shkuar dhe kam kërkuar miqtë shqiptarë, kam shikuar a janë ende gjallë. Kam qenë në Prishtinë tek disa miq, kur erdhi lajmi për ndalimin e Fehmi Aganit, gruas së tij dhe djalit të tyre. Më lajmëruan se e kanë marrë, ndërsa një ditë më vonë është gjetur trupi i tij i pajetë. Agani është vrarë ndërkohë që Millosheviqi i lejoi Rugovës të dalë nga vendi. Fehmi Agani ka menduar se edhe ai duhet të dalë nga Kosova dhe t'i bashkohet Rugovës. E gjithë fuqia e Rugovës ka qenë në mençurinë e Fehmi Aganit. Vdekja e Aganit është një humbje tepër e madhe jo vetëm për shqiptarët, por për tërë rajonin. Po të kishte mbetur gjallë ai, zhvillimet pozitive do të ishin më të shpejta dhe të gjitha do të ishin më ndryshe".

Udhëtimet e mija në Kosovë kanë qenë të tmerrshme, sepse kam parë edhe vet se çfarë po ndodhë. Shqiptarët kanë qenë në fillim të mbyllur në shtëpitë e tyre, nuk kanë guxuar të dalin në rrugë. Kam parë kolona të gjata refugjatësh, njerëz me qese në dorë, të humbur dhe pa orientim. Kur i pyesja ku po shkoni?, ata thoshin: Policia serbe na ka urdhëruar të shkojmë në Shqipëri. Njerëzit iknin në Shqipëri, ndërkohë që askush nuk i ndihmonte, nuk kishte asnjë organizatë të huaj humanitare atje

LIBRI I KUJTIMEVE NË KOSOVË

Në vitin 2015, Fondi ka botuar "Kosovske Knjige Pamćenja" (Librat e Kujtimeve në Kosovë). Synimi i këtij projekti ishte përcaktimi i numrit të saktë të viktimave në Kosovë. Koordinatore e projektit ishte Natasha Kandiq. Numri i të vrarëve në periudhën prej 1 janarit 1998 deri me 31 dhjetor 2000 është 13.535 persona.

Prej tyre 10.812 janë shqiptarë, 2.197 serbë, ndërsa 526 janë romë, boshnjakë, malazezë dhe të tjerë. Fondi për të Drejtën Humantiare në Beogad dhe Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë kanë botuar në vitin 2014 listën e personave të vrarë si pasojë e bombardimeve të NATO-s. Nga bombardimet kanë humbur jetën 754 persona, 454 civilë dhe 300 pjesëtarë të forcave të armatosura.

Ndër civilët janë 207 serbë dhe malazezë si dhe 219 shqiptarë civilë, 14 romë dhe 14 të nacionalitetëve të tjera. Ky burim thotë se janë vrarë 274 ushtarë dhe policë të ish-Jugosllavisë dhe 26 pjesëtarë të UÇK. Mbledhja e këtyre të dhënave ka filluar që në kohën e luftës.

"Mendoj se gati të gjithë do të reagonin si unë, po të shihnin këto kolona të refugjatëve, frikën dhe tmerrin që mbretëronte. Një ditë shkova për të blerë bukë në një dyqan në Prishtinë, në rend ishte një shqiptare. Dy serbe të tjera filluan të bërtisnin dhe nuk e lejuan të blejë bukë. Fillova edhe unë të bërtas kundër tyre... këto janë gjëra që nuk mund t'i harrosh. Në situata të këtilla e harron sigurinë personale, ajo më nuk është me rëndësi", kujton Kandiq. Udhëtimet e mija në Kosovë kanë qenë të tmerrshme, sepse kam parë edhe vet se çfarë po ndodhë. Shqiptarët kanë qenë në fillim të mbyllur në shtëpitë e tyre, nuk kanë guxuar të dalin në rrugë. Kam parë kolona të gjata refugjatësh, njerëz me qese në dorë, të humbur dhe pa orientim. Kur i pyesja ku po shkoni?, ata thoshin: Policia serbe na ka urdhëruar të shkojmë në Shqipëri. Njerëzit iknin në Shqipëri, ndërkohë që askush nuk i ndihmonte, nuk kishte asnjë organizatë të huaj humanitare atje. U ktheva në Beograd dhe shihja njerëzit që rrinin nëpër kafene, shikonin drejt qiellit dhe flisnin për kinse padrejtësitë e mëdha që po i bëhen Serbisë me bombardime. Kurrë askush nuk më ka pyetur se çfarë po ndodh në Kosovë, si është gjendja atje! Më ka zemëruar tepër një letër e një grupi intelektualësh të organizuar nga Open Society, me të cilën kërkohet përfundimi i bombardimeve në Serbi. Më ka zemëruar ky fokusim tek vetvetja, pa kurrfarë interesimi për atë se çfarë u ndodhte të tjerëve, pa kurrfarë interesimi për ndalimin e veprimeve të policisë dhe ushtrisë, vrasjeve, djegieve dhe shkatërrimeve në Kosovë".

"E VËRTETA" KOMBËTARE

Pas përpjekjeve intensive diplomatike të trojkës së drejtuar nga presidenti finlandez, Marti Ahtisari, e ku ishin edhe diplomatët amerikaën dhe rusë Strob Talbot dhe Viktor Çernomirdin, në qershor të vitit 1999, Sllobodan Millosheviqi pranoi kushtet e NATO-s. Me 9 qershor 1999 në Kumanovë u nënshkrua marrëveshja për tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova dhe vendosja e misionit paqësor KFOR në Kosovë. Lufa përfundoi ndërsa nga Kosova u largua një numër i madh i serbëve nga frika e hakmarrjes. Ata që kanë mbetur kanë jetuar në frikë nga mundësia e krimeve, të cilat kanë ndodhur kohë pas kohe edhe një vit më pas. Fondi ka mbledhur fakte edhe për këto krime.

"Ne shohim sot se në Serbi ekziston vetëm 'një e vërtetë', e vërteta kombëtare. Është krijuar edhe një Komision për hetimin e pasojave të bombardimeve të NATO-s, me qëllim që të dëshmohet se Serbia ka qenë viktimë. Paraqiten shifra që nuk kanë lidhje me faktet dhe harrohet në tërësi përgjegjësia e forcave serbe për një numër të madh të njerëzve të vrarë atje", thotë Kandiq.

"Harrohet se pse dhe si erdhi deri tek ndërhyrja e NATO-s. Çfarë i ka paraprirë ndërhyrjes dhe cili ishte roli i Serbisë në këtë mes. Ndërhyrja e NATO-s ka qenë një masë drastike, por mjeti i vetëm për të ndaluar ushtrinë dhe policinë serbe". *(DW)*

Kam qenë në Prishtinë tek disa miq, kur erdhi lajmi për ndalimin e Fehmi Aganit, gruas së tij dhe djalit të tyre. Më lajmëruan se e kanë marrë, ndërsa një ditë më vonë është gjetur trupi i tij i pajetë. Agani është vrarë ndërkohë që Millosheviqi i lejoi Rugovës të dalë nga vendi. Fehmi Agani ka menduar se edhe ai duhet të dalë nga Kosova dhe t'i bashkohet Rugovës. E gjithë fuqia e Rugovës ka qenë në mençurinë e Fehmi Aganit

"KOSHARJA", FILMI QË RRËFEN ANËN SERBE TË LUFTËS

Dokumentar,i që paraqet vetëm anën serbe të luftës, do të fillojë së emituari më 9 prill në RTS. Në mediet serbe Beteja e Koshares është cilësuar si ferri i luftës për ushtrinë e Serbisë.

Në Serbi vazhdon glorifikimi i humbjeve serbe dhe krijimi i miteve për to. Ky është stili i mbijetesës historike të Serbisë në përpjekje për të mbajtur territore të huaja jo vetëm që nga Beteja e Kosovës në vitin 1389 e deri më sot, 630 vjet më pas.

Një mit i tillë ka filluar të krijohet edhe për Betejën e Koshares në të cilën forcat serbe u thyen nga forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për ta përkujtuar këtë betejë, televizioni publik serb njofton se është në përfundim e sipër filmi, dokumentar e quan rts, me titull "Rrëfime lufte nga Kosharja". Ky film, sipas autores së tij Sllagana Zariq është xhiruar në Kopaonik, në reliefe dhe kushte atmosferike të me ato të Bjeshkëve të Junikut Filmi merret me kronologjinë e ngjarjeve filluar më 9 prill 1999 kur forcat e UÇK-së sulmuan forcat serbe që qëndronin në kufirin shqiptaro -shqiptar. Beteja ka zgjatur 67 ditë, deri më 14 qershor 1999 kur ushtria jugosllave u largua përfundimisht nga Kosova. Dokumentar,i që paraqet vetëm anën serbe të luftës, do të fillojë së emituari më 9 prill në rts. Në mediet serbe Beteja e Koshares është cilësuar si ferri i luftës për ushtrinë e Serbisë.Gjenerali i pensionuar serb i dënuar për krime lufte, Vladimir Lazareviq, i cili ishte komandant i Korpusit të Prishtinës të ish-Ushtrisë Jugosllave gjatë kohës së luftës në Kosovë, part zbuluar në mediat serbe dëshmitë e tij nga koha e luftës dhe tmerrin e Betejës së Koshares. Sipas tijmë më 9 pril ndodhi thyerja e kufirit dhe hyrja e trupave të UÇK-së në Kosovë nga Shqipëria.

"Sulmi ishte i tmerrshëm, dhe armiku ishte shumë, i armatosur mirë, me mbështetje të mirë ajrore dhe instruktorët më të mirë të NATO-s... Ishte një Vietnam në miniaturë. Nuk ishte beteja vetëm e Karakollit të Koshares, ishte një front prej 15 kilometrash", ka thënë Llazareviq.

Publicitet

Sipas nenit 84 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.124/15) Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, pavarësisht përpjekjeve për të kryer shpërndarjen e akteve administrative të miratuara në procedurë administrative bën shpallje publike përmes:

NJOFTIM

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ka sjell akte administrative të cilat nuk mund t`i parashtrojë personalisht edhe atë:

1. Vendimi nr. 2016-68-0001260/2 i datës 13.11.2018 për Avdili Nura, Vaksince 1306, komuna Likovë, Kumanovë.
2. Vendimi nr. 2016-78-0006522/2 i datës 13.11.2018 për Tashev Tasho, rr.Gjorgji Trajkov nr.6, Strumicë.
3. Vendimi nr. 2016-78-0000305/2 i datës 13.11.2018 për Neceva-Janeva Irinka, f.Velusa 2414, Strumicë.
4. Vendimi nr. 2016-78-0006478/2 i datës 13.11.2018 për Projkov Petar, rr.Geras Cunev 7, Strumicë.
5. Vendimi nr. 2016-67-0000252/2 i datës 13.11.2018 për Jakimoviq Desa, Vladimir Komarov nr.12, Aerodrom, Shkup.
6. Vendimi nr. 2016-78-0004231/2 i datës 13.11.2018 për Angelov Gjorgji, f.Banicë, Strumicë.
7. Vendimi nr. 2016-78-0002223/2 i datës 13.11.2018 për Jangelovski Mladen, rr.Braqa Milladinovi nr.39/1-8, 2400 Strumicë.
8. Vendimi nr. 2016-78-0000857/2 i datës 13.11.2018 për Vitanov Branko, rr.Edinstvo nr.5, Kavadar.
9. Vendimi nr. 2016-78-0005858/2 i datës 13.11.2018 për Vitanov Tusho, f.Veljusë 2414, Strumicë.
10. Njoftimi nr. 12-5/263 i datës 13.02.2019 për Lita Shpknjp Ohër, f.Velgoshti, 6330 Strugë.
11. Vendimi nr. 12-1250/4/10 i datës 15.02.2019 për DPTU Biljana Promet, rr.6 nr.10 Ilinden, Shkup.
12. Vendimi nr. 12-1250/11/5 i datës 20.02.2019 për Margo Shpknjp, rr.Partizanska nr.84-3, Shkup.
13. Vendimi nr. 12-1250/4/15 i datës 15.02.2019 për PAM-EKS SHPKNJP, rr.Blagoj Gjorev pn, Veles.
14. Vendimi nr. 12-1250/11/19 i datës 20.02.2019 për DPTU Biljana Promet SHPK, rr.6 nr.10 Ilinden, Shkup.
15. Vendimi nr. 12-1250/11/6 i datës 20.02.2019 për fermën e shpezëve "Gjashtë vëllezërit" rr.1 nr.133 komuna Studeniçan, Shkup.
16. Vendimi nr. 12-125/4/12 i datës 15.02.2019 për fermën e shpezëve "Gjashtë vëllezërit", rr.Pero Nakov pn - Shkup.
17. Apeli nr. 12-1-24/2 i datës 07.02.2019 për Aleksandar Mazni, rr.Nju Delhiska nr.9, Shkup.
18. Njoftimi nr. 2018-55-0051922/3 i datës 05.02.2019 për Ranç N Dooel, rr.4 nr.66, f.Rzhaniçinë, komuna Petrovec, Shkup.
19. Njoftimi nr. 2018-79-0001508/3 i datës 08.02.2019 për Shabanoski Shaban, Belicë e poshtme 6334, Strugë.
20. Njoftimi nr. 2018-51-0098338/3 i datës 17.01.2019 për Muaremovski Tela, rr.A pn, Ostrec, Manastir.
21. Njoftimi nr. 2018-75-0002009/2 i datës 24.10.2018 për Agro Delta, f.Vrashticë e poshtme, komuna Konçe, Radovish.
22. Vendimi nr. 12-5/49 i datës 10.01.2019 për DPP "Cek-Komerc" SHPK Import-Eksport, rr.Sheshi Ilinden nr.20-4, Sveti Nikolle.
23. Vendimi nr. 12-5/50 i datës 10.01.2019 për UNI AGRO SHPK, rr. Zhivko Firov nr.63, Veles.
24. Njoftimi nr. 16-766/5 i datës 25.03.2019 për DOMAIN BAROVO SHPKNJP, rr. Vlladimir Polezhinovski nr.14, Qendër Shkup.

Ftohen personat e lartpërmendur në afat prej 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të njoftimit të lajmërohen në hapësirat e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural - Shkup për ngritjen e vendimeve, në qoftë se nuk lajmërohen, ky njoftim me shpallje publike do të konsiderohet si dorëzim i rregullt në pëlqim me nenin 84 paragrafi 6 nga Ligji për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 124/15).

Nuhiu, 6 fitore në shtatë ndeshje me Dritën

Shkup, 2 prill - Pranvera duket tjetër për Dritën që kur Ardian Nuhiu mori detyrën e kryetrajnerit të kjo skuadër. Pas eliminimit nga gara për DigitAlb Kupën e Kosovës dhe largimin e trajnerit Shpëtim Duro, duket se gjërat tashmë kanë rënë në binarë, pasi që tekniku shkupjan ka vënë dorën e tij mbi ekipin dhe rezultatet flasin më së miri. Gjashtë fitore në shtatë ndeshje, prej tyre pesë fitore radhazi ku spikat fitorja në debutim përballë rivalit lokal Gjilani (3-1) janë shifrat magjike që ka arritur tekniku shkupjan me të marrë drejtimin e kampionëve në fuqi. 12 gola të shënuar dhe vetëm katër të pranuar janë shifra që do ti kishte lakmi çdo trajnerë tjetër, për më tepër që ka grumbulluar 18 pikë dhe nëse kampionati do të niste nga pjesa pranverore atëherë Drita do të kryesonte renditjen. I thjeshtë dhe modest, Nuhiu i jep gjithë kreditet futbollistëve të tij që për hir të së vërtetës kanë qenë fantastik në këtë pranverë, por minusi i madh i krijuar në pjesën vjeshtore të kampionatit u ka pamundësuar atyre të mbrojnë titullin kampion. Që nga starti i pranverës dhe del se bardhekaltërit janë ekipi dukshëm më i mirë në Ipko Superligë. Pas tyre vijnë Feronikeli dhe Llapi që kanë tubuar një, respektivisht dy pikë më pak. Zhgënjyese është forma e Gjilanit që ka marrë vetëm gjashtë pikë në shtatë javë, që do të thotë se nuk ka arritur të marrë as edhe një pikë për ndeshje.

RENDITJA KAMPIONALE PAS PJESË PRANVERORE TË KAMPIONATIT

DRITA	18 PIKË
FERONIKELI	17
LLAPI	16
PRISHTINA	13
FERIZAJ	10
DRENICA	9
BALLKANI	8
FLAMURTARI	7
TREPCA 89	7
GJILANI	6
LIRIA	5
KEK-U	0

LIGA E PARË - JAVA E 26

RENOVA PËRBALLË SHKUPIT, SHKËNDIJA MYSAFIRE E AKADEMIJA P

"Na pret një ndeshje e vështirë në Tetovë kundër Renovës, mirëpo ne jemi të gatshëm për të dhënë maksimumin në fushë që të marrim një rezultat pozitiv për të rikthyer kënaqësinë në klub dhe tek fansat tanë", deklaroi Enes Azizi

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 2 prill - Pas ndeshjeve të zhvilluara në mesjavë të dielën do të kthehen në program takimet e javës së 26 në Ligën e Parë futbollistike të Maqedonisë së Veriut. Derbi i xhiros do të luhet në qytetit e Tetovës, ku do të përballën vendasit e Renovës me skuadrën e FC Shkupit. Do të jetë një ndeshje shumë interesante pasi të dyja ekipet luftojnë për vendin e katërt në tabelë, ndërsa pas 25 xhirove të zhvilluara, Renova dhe Shkupin kanë pikët e barabarta (33 pik). "Pas disa rezultateve ku na ka munguar fati, jemi të bindur të gjithë se kjo është vetëm një faze qe do te kaloje shpejt. Ne besojmë në grupin tonë dhe në kualitetet tona për tu rikthyer në formën që kemi qenë. Tani na pret një ndeshje e vështirë në Tetovë kundër Renovës, mirëpo ne jemi të gatshëm për të dhënë maksimumin në fushë që të marrim një rezultat pozitiv për të rikthyer kënaqësinë në klub dhe tek fansat tanë", deklaroi Enes Azizi. Skuadra do të ketë mungesë vetëm Rron Brojën, shkaku i pesë kartonëve të verdhë. Nga ana tjetër kampioni aktual Shkëndija do të udhëtojë drejt Strumicës, ku do të jetë mysafire e Akademija Pandevit, të cilët po zhvillojnë një sezon të suksesshëm, ku e dëshmon edhe vendi i tretë në tabelën e klasifikimit. Skuadra vendase Akdemija Pandev, në këtë përballje do të jetë pa shumë lojtarë të formacionit të parë, për shkak të lëndimeve si dhe lojtarëve të cilët janë të suspenduar nga kartonët e marrë. Mirërpo vendasit në këtë takim do të futen me qëllimin e tyre që të dalin të pamposhtur për të vazhduar drejt qëllimit të tyre për të ruajtur vendin e tretë në tabelë. Nga ana tjetër "Kuqezinjtë" për këtë takim janë përgatitur maksimalisht dhe shpresojnë se nga Strumica do të rikthehen me fitore për të vazhduar serinë pozitive të rezultateve.

"Na pret një ndeshje interesante me një kundërshtarë që po bën një sezon të mirë siç është Akadmija Pandevi i respektojmë ata rezultatet e tyre dhe cilësinë që kanë, por dien ambiciet tona dien qëllimet tona dhe ne shkojmë të fitojmë në çdo ndeshje. Kemi hyre në një seri të mirë posaçërishtë pas pauzëz në kampionat, kemi fituar me rezultate bindëse dhe tash sigurisht që duam të vazhdojmë me këtë seri. Në Strumicë shkojmë për një tjetër paraqitje pozitive dhe me angazhimin e të gjithëve të marim tre pikë nga kjo përballje", deklaroi Stenio Zhunior. Ndërkaq, në takimet tjera që do të luhen ditën e mërurë (sot) do të takohen: Pobeda në shtëpi pret Vardarin, Sileksi do të jetë nikoqire e Makedonija Gj.P dhe Rabotniçki luan me Belasicën. Të gjitha takimet do të nisin me fillim prej ora 15:30.

Klubet italiane në "luftë" për Elif Elmas

Shkup, 2 prill - Interesimi i shumë skuadrave për lojtarin e reprezentacionit të Maqedonisë, Elif Elmas ka bërë që vlera e kartonit të tij të rritet edhe më shumë në treg, posaçërisht pas ndeshjeve të mira që zhvilloi me përfaqësuesen e Maqedonisë në fillim të kualifikimeve për kampionatin Evropian 2020. Fiorentina dhe Lacio janë ekipet më të interesuara për momentin, me Elmas, ndërsa sipas mediumeve italiane skuadrat tani më vetëm kanë dërguar ofertë drejt skuadrës së Fenerbahçes, për të marrë shërbimet e lojtarit shkupjan. Sipas gazetës italiane "Tutosport", Fiorentina ka ofruar 15 milion euro për Elif Elmas, por skuadra turke ende nuk ka kthyer përgjigj drejt ekipit italian. Burimet e njëjta konfirmojnë se shumë shpejt pritet që edhe Lacio të dërgon ofertë, e cila pritet të jetë më e lartë se ajo e Fiorentinës. Lacio pritet që të lirohet nga shërbimet e Milenkoviç Saviç ndërsa vendin e tij ta zëvendësojnë me lojtarin e reprezentacionit të Maqedonisë. *(F.N)*

Meha përfundon në ligë amatore në Gjermani

Alban Meha ka lënë skuadrën e SV Elversbergut për të kaluar te Hessen Kassel. Alban Meha, futbollisti që e veshi fanellën e Kombëtares së Shqipërisë dhe Kosovës, një lojtar fantastik dhe i talentuar, ka përfunduar në ligë amatore në Gjermani, në atë të pestë. Sipas gazetës "hna.de", 32-vjeçari ka lënë SV Elversbergun për të kaluar te Hessen Kassel. Meha u largua nga SV Elversberg pas një sezoni pozitiv sepse shënoi 8 gola dhe asistoi njëherë në 16 paraqitje.



Bundesliga e Milot Rashicës

Milot Rashica nuk pati natë të mirë në Prishtinë në ndeshjen e Kosovës me Bullgarinë (1:1) në kualifikimet për "Euro 2020". Por, ylli kosovar vazhdon të shkëlqejë në Werder Bremen. Rashica e realizoi një gol dhe asistoi në një tjetër gol në fitoren prej 3:1 të skuadrës së tij ndaj Mainzit në fundjavën e kaluar. Kjo paraqitje fantastike ka bërë që Rashica të përzgjedhet sërish në formacionin e javës në Bundesligën gjermane, krahas yjeve të tjerë si Da Costa, Guerrero e Poulsen. Lojtari anësor deri më tani ka pasur 28 paraqitje për Werder bremenin dhe i ka shënuar 9 gola në të gjitha garat. 8 sosh i ka realizuar vetëm në Bundesligë. Ai është golashënuesi i dytë më i mirë i Werderit, pas Kruses, që ka shënuar 10 gola në kampionat.

Në bazë të nenit 17, nenit 18 dhe neni 19 nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënës të shkollave fillore të MASH nr.07-9992/2 të datës 05.06.2014, SHF "Goce Dellçev" - Konçe shpall

SHPALLJE
për realizimin e procedurës për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve për vitin shkollor 2018/2019

1. Organi kontraktues:
SHF "Goce Dellçev" - Konçe
adresa: f.Konçe, 2424 Konçe
tel:032/649-145; e-mail: goce_delcev_konce@yahoo.com

2. Përshkrimi i shërbimit: Shërbimi është i ndashëm dhe çdo ofertë duhet të jetë në zarf të veçantë.

2.1. Ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së tretë - për 41 nxënës në periudhën e muajit maj 2019

Nisje në ora 8 para shkollës. Gjatë rrugës shëtitje të tipareve të Maqedonisë lindore. Vizitë të Strumicës me njohje të tipareve dhe të kaluarën historike të qytetit - vizitë të oranzherive me njoftim të procesit për kultivimin e perimeve. Vizitë të banjës dhe njoftim për rëndësinë e saj dhe mënyrën e punës. Vizitë të manastirit Vodoça dhe njoftim me të kaluarën tonë. Kthim në ora 16 deri të të gjitha vendbanimet e nxënësve.

Në çmimin e ofertës të jenë të llogaritura shërbimet në vijim:
- transportim me autobusë të lartë turistik në relacionin e cekur,
- për te gjithë objektet që do te vizitohen në çmim të jetë e llogaritur edhe çmimi i biletës,
- të siguruara 5 gratis për mësimdhënësit
- organi kontraktues e mban të drejtën ta caktoj datën për realizim të ekskursionit,
- organi kontraktues e mban të drejtën ta ndryshoj numrin e nxënësve varësisht nga interesimi i nxënësve,
- ekskursionin e financon prindi/kujdestar i nxënësit, me pagesën e mjeteve financiare të subjektit juridik i cili e realizon ekskursionin.

2.2. Ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së gjashtë - për 32 nxënës në periudhën e muajit maj 2019

Dita 1 - Nisje në ora 6.30 nga f.Konçe drejt Kavadarit, vizitohet Stobi, pastaj nisje drejt Prilepit dhe vizitohet Qyteti i epërm dhe kullat e Markos, nisje drejt Manastirit. Akomodim në hotel në qendër të qytetit Manastir në të cilin ka të organizuar drekë. Pas drekës vizitohet Heraklea dhe parku nacional "Pelister". Kthim në hotel, aktivitete të lira nëpër qendrën e qytetit. Darkë dhe fjetje organizuar në hotelin.

Dita 2 - Pas mëngjesit në hotel, merren lunch pako për drekë nga hoteli **(sandviç me stek pule, sallatë dhe lëng)** dhe nisje për Gostivar, vizitë të burimit të lumit Vardar "Vrutok", pastaj nisje për Tetovë, kalohet pranë Xhamisë së larme. Nisje për Shkup vizitë të shtëpisë përkujtimore të Nënës Terezë dhe QTQ, Xhambo dhe Çarshia e Vjetër, kthim përmes Velesit dhe Shtipit. **Kthimi i nxënësve deri në vendin e banimit deri te të gjitha vendet e banuara në komunën Konçe.**

Në çmimin e ofertës të jenë të llogaritura shërbimet në vijim:
- transportim me autobusë të lartë turistik në relacionin e cekur,
- për te gjithë objektet që do te vizitohen në çmim të jetë e llogaritur edhe çmimi i biletës,
- te siguruara 2 gratis për mësimdhënësit
- organi kontraktues e mban të drejtën ta caktoj datën për realizim të ekskursionit,
- organi kontraktues e mban të drejtën ta ndryshoj numrin e nxënësve varësisht nga interesimi i nxënësve,
- ekskursionin e financon prindi/kujdestari i nxënësit, me pagesën e mjeteve financiare të subjektit juridik i cili e realizon ekskursionin.

2.3. Ekskursion treditor për nxënësit e klasës së nëntë - për 34 nxënës në periudhën e muajit maj 2019.

Dita 1 - Nisje në orën 06:30 nga f.Konçe drejt Kavadarit me vizitë të Stobit, nisja drejt Prilepit dhe vizita e Qytetit të lartë dhe Kullat e Markos, vizitë qytetit të Manastirit, aktivitete të lira në qendrën e qytetit pastaj vizitë të lokalitetit antik Heraklea dhe nisja drejt qytetit të Ohrit. Akomodim dhe fjetje në hotel i cili duhet të jetë në qendër të qytetit dhe **(në të të jetë organizuar ushqimi**), aktivitete të lira dhe darkë në hotel.

Dita 2 - Mëngjes. Pas mëngjesit vizitohen vendet me karakteristika më të mëdha të qytetit të Ohrit – Vizita e monumenteve siç janë Lihnidos, Pllaushnik, kalaja Samoillove, Kisha "Shën Sofia", çarshia e vjetër, drekë në hotel. Pasdite shkohet në "Shën Naum Ohridski" dhe pasdarke **në hotel** mbahet darkë solemne e përcjellur **me muzikë të gjallë e cila është e përfshirë në çmimin e ofertës.**

Dita 3 – Mëngjes. pas mëngjesit nisja për në Strugë dhe vizitohet Muzeu natyror-shkencor **(bileta për hyrje duhet të jetë e futur në ofertën)**. Për drek merret lanç pako **(sandviç me stek pule, sallatë dhe lëng**), nisja drejt Gostivarit dhe vizitohet burimi i lumit Vardar "Vrutok", nisja drejt Tetovës ku vizitohet manastiri i Leshkës dhe Xhamia e larme, nisja drejt Shkupit ku vizitohet shtëpia përkujtimore e Nënë Terezës dhe QTQ pastaj kthimi mbrapa nëpërmjet Velesit dhe Shtipit. **Kthimi i nxënësve deri në vendin e banimit deri te të gjitha vendet e banuara në komunën Konçe.**

Në çmimin e ofertës të jenë të llogaritura shërbimet në vijim:
- transportim me autobusë të lartë turistik në relacionet e cekura,
- për te gjithë objektet që do te vizitohen në çmim të jetë e llogaritur edhe çmimi i biletës,
- te siguruara 2 gratisa për mësimdhënësit
- organi kontraktues e mban të drejtën ta caktoj datën për realizim të ekskursionit,
- organi kontraktues e mban të drejtën ta ndryshoj numrin e nxënësve varësisht nga interesimi i nxënësve,
- ekskursionin e financon prindi/kujdestari i nxënësit, me pagesën e mjeteve financiare të subjektit juridik i cili e realizon ekskursionin.

3. Përmbajtja e ofertës

Vërejtje: Për secilin ekskursion ofertat do të shqyrtohen veç e veç. Ofertuesi varësisht se a jep ofertë për ekskursionin njëditor, dyditor apo treditor ofertat duhet ti vendosë në zarf të veçantë me shenjën se për cilin ekskursion jep ofertë.

Nën pikën 1- për ekskursion njëditor (2.1)
- çmim individual dhe të përgjithshëm për shërbimin sipas përshkrimit të dhënë në pikën 2.1 të kësaj shpallje, me guid të siguruar dhe mjek të siguruar
- dokumente në pajtim me pikën 4, 5 dhe 6 të kësaj shpallje
- oferta nuk duhet të përmbajë zgjidhje alternative

Nën pikën 2- për ekskursion dyditor (2.2)
- çmim individual dhe të përgjithshëm për shërbimin sipas përshkrimit të dhënë në pikën 2.2 të kësaj shpallje, me guid të siguruar dhe mjek të siguruar
- dokumente në pajtim me pikën 4, 5 dhe 6 të kësaj shpallje
- oferta nuk duhet të përmbajë zgjidhje alternative

Nën pikën 3- për ekskursion treditor (2.3)
- çmim individual dhe të përgjithshëm për shërbimin sipas përshkrimit të dhënë në pikën 2.3 të kësaj shpallje, me guid të siguruar dhe mjek të siguruar
- dokumente në pajtim me pikën 4, 5 dhe 6 të kësaj shpallje
- oferta nuk duhet të përmbajë zgjidhje alternative

4. Kushtet minimale të cilat duhet t`i plotësojë ofertuesi:
- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në R.M. për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike,
- Me sukses të ketë të realizuara së paku 3 ekskursione për nxënës dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit,
- Të përmbushë kushtet për transport të grupit të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve,

5. Dokumentet të cilat duhet t`i dorëzojë ofertuesi së bashku me ofertën:
- dokument për veprimtari të regjistruar,
- kopje të marrëveshjeve si dëshmi që ka të realizuar me sukses më së paku 3 ekskursione për nxënës dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit, me vulë nënshkrim dhe shenjë "Besnike ndaj origjinalit"
- vërtetim për plotësimin e kushteve teknike-eksploatuese për transport
- deklaratë me të cilën ofertuesi deklaron se i plotëson kushtet për transport të grupit të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve
- deklaratë për guid të siguruar
- deklaratë për mjek të siguruar
- deklaratë që siguron gratis për mësimdhënësit në pajtim me numrin e cekur në pikën 2 të kësaj shpallje

Vërejtje: Nëse ofertuesi merr pjesë me ofertë për dy ose për tre ekskursionet, ai është i obliguar të dorëzojë oferta në zarf të veçantë për çdo ekskursion dhe me çdo ofertë dokumentacionin e kërkuar dorëzohet veçmas!

6. Garancia bankare

Në ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur dorëzon garanci bankare në vlerë prej 5% nga çmimi i përgjithshëm i vlerës së marrëveshjes, për çdo marrëveshje veçmas.

7. Kriteret për dhënien e marrëveshjes për realizimin e ekskursionit:
Çmimi më i ulët.

8. Ofertuesi mund të dorëzojë ofertë për një, dy apo për tre ekskursionet veçmas në zarf të veçantë. Oferta duhet të jetë në zarf të veçantë për çdo ekskursion me shenjë: "Mos e hap" për komisionin për grumbullimin e ofertave dhe e shënuar "Për ekskursion njëditor"; " Për ekskursion dyditor" ose " Për ekskursion treditor".

9. Afati i fundit, vendi dhe mënyra e dorëzimit të ofertës:

Oferta së bashku me dokumentacion e plotë dorëzohen deri të shkolla në zarf të mbyllur në afat prej 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit të kësaj shpallje. Ofertat e pakompletuara, ofertat me zgjedhje alternative dhe ofertat jo në kohë nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

Komisioni për grumbullimin e ofertave pranë
OU "Goce Dellçev" - Konçe

FEDERATA E FUTBOLLIT TË MAQEDONISË

Publikon

S H P A L L J E

Për angazhim të ndihmës trajnerit të futbollit për punë me futbollistë në paralelen për futboll në DSU Akademia e sportit në Shkup. Konkursi publikohet sipas nenit 15 të Ligjit për DSU Akademia e sportit dhe dispozitave të Rregullores për kriteret e veçanta për trajner të nxënësve në akademinë e sportit.

- **Në Shkup kërkohet 1 (një) ndihmës trajner**

Kushtet e përgjithshme të cilat kandidatët për trajner dhe ndihmës trajner duhet t`i plotësojnë janë:
- të ketë të mbaruar së paku arsim të lartë në sferën e sportit ose licenca të arritura të marra nga ndonjë asociacion sportiv përkatës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos ketë të shquar dënim ose sanksion për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e veçanta të cilat kandidatët për trajner ose ndihmës trajner duhet t`i plotësojnë janë:

- të posedojë vërtetim për së paku dy vite punë në klub në kategorinë përkatëse për të cilën është kandidat në pesë vitet e fundit, ose vërtetim për së paku pesë vite stazh pune si trajner me diplomë përkatëse B, A ose PRO të lëshuar nga Federata e Futbollit të Maqedonisë,
- të posedojë vërtetim që nuk ka të shquar masë disiplinuese nga ana e organit disiplinues të Federatës së Futbollit të Maqedonisë në pesë vitet e fundit,
- të posedojë aftësi për komunikim, organizim dhe menaxhim, si dhe aftësi për transferim të njohurive dhe aftësive, dhe
- të ketë arritur rezultate në karrierën e tij profesionale, gjegjësisht të fituar kampionat, trofe ose performancë në gara evropiane.

Përparësi gjatë zgjedhjes së trajnerit nga paragrafi (1) të këtij neni kanë kandidatët të cilët njohin së paku një gjuhë botërore, që përcaktohet me posedimin e certifikatës të njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatori oficial evropian, anëtar i shoqërisë ALTE të testatorëve evropian ose certifikatë nga institucioni ndërkombëtar për A2 nivel të CEFR, gjegjësisht BULATS; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose Gete certifikatë.

Të gjithë kandidatët e interesuar **CV** e tyre, në gjuhën maqedonase, me të gjitha dokumentet e nevojshme në origjinal (përveç diplomën e trajnerit e cila mund të jetë kopje), t`i parashtrojnë deri te Federata e futbollit të Maqedonisë përmes postës në adresë, ose personalisht në arkivin e FFM në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e publikimit:

Federata e Futbollit të Maqedonisë
Bul. ASNOM - nr.21 lgj. Lisiçe e re,
1000 Shkup
me shenjën ***për ndihmës trajner në paralelen - futboll në Shkup***

FFM, e mban të drejtën të kryen testim plotësues të kandidatëve të cilët kanë rezultate të njëjta ose të ngjashme në kuotën e paraparë. Të gjithë kandidatët që do t`i plotësojnë kushtet për pranin, do të informohen më tej për aktivitetet e mëtutjeshme, përderisa fletëparaqitjet e pakompletuara dhe jo të rregullta nuk do të shqyrtohen.

FEDERATA E FUTBOLLIT TË MAQEDONISË
MUAMED SEJDINI
Kryetar

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16,163/16, 64/18, 168/18) dhe Vendim me nr. 10-819/4 dt. 29.03.2019 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

K O M U N I K A T Ë
për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike të përsëritur për Propozim Planin detal urbanistik për Bllokun Urban 10

Njoftohen qytetarët e komunës së Tetovës se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike të përsëritur sipas **Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 10KK Tetovë 1 dhe Tetovë jashtë r. nd., komuna e Tetovës** me nr.teknik 2-8/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë.
Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr.”Video Smilevski Bato”, rr. “159”, hekurudha Shkup-Kërçovë dhe në pjesën verilindore kufizohet përgjatë parcelave kadastarale nr. 5707, 5695/4 dhe 1304, me periudhë planore prej 2016-2021 vjet.
Përfshirja është me sipërfaqe prej 8.04 ha.
Brenda përfshirjes planore të bllokut 10, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, V3 – Kulturë, G4 – Depo, E2 - Suprastrukturë komunale, D2 - Gjelbërim mbrojtës, E1 - Infrastrukturë komunale.

ANKETA PUBLIKE E PËRSËRITUR sipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 10, komuna e Tetovës, do të zgjas 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 15.04.2019-19.04.2019.
Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) mediume publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhenë sistemin e e-urbanizmit.

PREZANTIMI PUBLIKI PËRSËRITUR sipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 10, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 16.04.2019 në ora 11:00, në zyrën nr.20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike të përsëritur është e publikuar në (2) mediume publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.
Listat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t’i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr.20 në komunën e Tetovës ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë me planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese.

Shtojca grafike e Planit detal urbanistik në Bllokun Urban 10, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

PESË TRAJNERËT MË TË PAGUAR NË BOTË, DY JANË PA PUNË

France Football e ka publikuar listën me trajnerët me pagat më të larta në botën e futbollit dhe trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, e kryeson këtë listë me një dallim të madh prej kolegëve të tij

Një herë e një kohë trajnerët nuk ishin personazhet më të paguar në klubet e futbollit, ndërkohë që në qendër të vëmendjes ishin futbollistët, ata që dhurojnë spektaklin në fushë. Megjithatë, kohët kanë ndryshuar dhe gjithnjë e më shumë klubet e mëdhenj po shpenzojnë miliona për trajnerët, duke e ditur se një skuadër e fortë nuk fiton dot pa një strateg në stol. France Football ka publikuar listën e trajnerëve më të paguar në planet dhe çuditërisht dy prej tyre janë pushuar nga puna këtë sezon, por natyrisht vazhdojnë të paguhen, për sa kohë nuk kanë gjetur ekip të ri.

Ernesto Valverde (Barcelona, 23 milionë euro) - Në vendin e pestë të renditjes së trajnerëve më të paguar qëndron Ernesto Valverde, i cili ka një kontratë deri në vitin 2020 dhe nga kjo fut në xhep 23 milionë euro në total. Barcelona është në garë për 3 trofe këtë sezon dhe në fillim të këtij viti Barcelona vendosi të zgjaste edhe një vit kontratën me trajnerin e vet.

Pep Guardiola (Manchester City, €24m) - Para trajnerit aktual të Barcelonës qëndron ish-trajneri i Barcelonës, Pep Guardiola, i cili merr 24 milionë euro te Manchester City. Edhe Guardiola synon ta mbyllë sezonin me 3-4 trofe, me Champions League si objektiv kryesor, natyrisht. Guardiola ka shpenzuar shifra të frikshme te City, por ka ndërtuar një skuadër të jashtëzakonshme dhe nëse ia del, milionat e shpenzuara ia kanë vlejtur plotësisht.

Thierry Henry (ish-Monaco, €25.5m) - Futbollist i madh, automatikisht trajner i mirë? Ky është rregulli që thuajse asnjëherë nuk funksionon dhe për këtë mjafton të shohim Thierry Henry. Ish-sulmuesi legjendar nisi punën si trajner para disa muajsh, por dështoi dhe Monaco e largoi brenda 3 muajsh. Gjithsesi, kontrata 3-vjeçare firmosur në tetor i garanton 25.5 milionë euro, për vetëm 4 fitore në 20 ndeshje në drejtim. T'i ndodhte në Shqipëri, do detyrohej të kthente pas edhe paratë e marra për 3 muaj punë.

José Mourinho (ish-Man Utd, €31m) - Trajneri që ka fituar si pak të tjerë në histori, trajneri që si askush i përçan mediat dhe tifozët në vlerësimin kundrejt tij. The Special One fitoi 31 milionë euro gjatë periudhës së qëndrimit në Old Trafford, por u pushua nga puna në dhjetor, për shkak të ecurisë së dobët dhe problemeve të brendshme.

Diego Simeone (Atlético Madrid, €41m) - Trajneri më i paguar në botë është një surprizë, sepse pakkush e pret që Atletico të shpenzojë kaq shumë. Megjithatë, Diego Simeone është një institucion në Madrid dhe tashmë fiton 41 milionë euro nga Los Colchoneros, me kontratën që i zgjat deri në 2022. Ndonëse eliminimi nga Juventusi këtë sezon në Champions ishte një goditje e rëndë, Simeone mbetet një ndër trajnerët më të mirë në botë dhe me Atletico-n ka fituar shumë trofe.



Griezmann 100% do të qëndrojë në Atletico

Antoine Griezmann nuk do të transferohet në Barcelonë, ai do të vazhdojë ta veshë fanellën e Atletico Madridit, gjithmonë sipas Enrique Cerezos. Sulmuesi francez, Antoine Griezmann, ishte afër kalimit në Barcelonë verën e kaluar, por konfirmoi qëndrimin në kryeqytetin e Spanjës përmes një dokumentari pak ditë para startit të Kupës së Botës "Rusia 2018". Megjithatë, sezoni jo i mirë që po kalon me Atleticon, vetëm 12 gola në Ligë në 29 paraqitje dhe mbetja jashtë çdo gare për titull – ka rikthyer edhe njëherë thashethemet për një kalim të mundshëm të francezit në "Camp Nou". Por, gjithçka ka hedhur poshtë numri një i klubit madrilen, Enrique Cerezo, i cili ka përsëritur se Griezmann nuk do të largohet nga Atletico. "Griezmann nuk do të largohet", tha numri një i Atleticos për RTVE. Gazetari insistoi dhe e pyeti përsëri, 'Griezmann është i sigurt, ju gjithashtu jeni 100% të sigurt? Cerezo ia ktheu: "Antoine do të qëndrojë në Atleti, të jeni të sigurt". Por, nëse arrin në klub shifra e klauzolës prej 120 milionë eurove, Cerezo s'do të ketë zgjidhje tjetër veçse ta lë të largohet 28-vjeçarin.

Suning shton buxhetin për blerjet e trajnerit të ri

Inter është në një pikë kyçe të sezonit, por situata e krijuar brenda grupit nuk është aspak e qetë. Mauro Icardi e ka marrë ndëshkimin e tij, por në fund të sezonit pritet që trajneri Luciano Spalletti të marrë edhe ai një "shuplakë" finale. Sipas asaj që shkruan "Corriere dello Sport" Spalletti do të largohet nga zikaltrit në fund të këtij sezoni edhe pse ka kontratë për dy vitet e ardhshme dhe paga e tij është 4 milionë euro në sezon, 8 milionë euro humbje për klubin nëse shkarkohet. Në listën e drejtuesve për të zënë vendin e tij është Jose Mourinho, por më shumë përparësi ka Antonio Conte, i cili është trajner i lirë. Për të bërë të mundur këtë lëvizje kompania "Suning" e drejtuar nga pronari i Inter, Zhang Jindong por krijon të gjitha mundësitë nga sponsorët në Azi për të rritur buxhetin e klubit që të përballojë shpenzimet e ardhjes së trajnerit të ri, i cili po ashtu do të ketë një fond më vete për lojtarët që dëshiron të blejë.

Publicitet

KOMUNA KARPOSH
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Karposhit, në vijim sjellë

L A J M Ë R I M

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike për Dokumentacionin lokal planor-urbanistik për G4 - Depo me sallon ekspozues për PK 130/1, KK Bardovc, m.v Gllaviçicë, Komuna Karposh, Shkup.

Anketa publike në lidhje me Dokumentacionin lokal urbanistik planor për G4 - Depo me sallon ekspozues për PK 130/1, KK Bardovc, m.v Gllaviçicë, Komuna Karposh, Shkup, do të mbahet prej datës 08.04.2019 deri më 12.04.2019, çdo ditë pune, nga ora 07:30 deri 15:30, në hapësirat e Komunës Karposh (Baraka 2 - rr.Radika nr.9).

Prezantimi publik në lidhje me Dokumentacionin lokal urbanistik planor për G4 - Depo me sallon ekspozues për PK 130/1, KK Bardovc, m.v Gllaviçicë, Komuna Karposh, Shkup, do të mbahet më datë 12.04.2019 në ora 13.00, në hapësirat e Komunës Karposh (Baraka 2 - rr.Radika nr.9).

Hapësira për të cilën miratohet Dokumentacioni lokal urbanistik planor ndodhet jashtë kufijve të PNU të qytetit Shkup (2012-2022) dhe jashtë Planit urbanistik për fshatin Bardovc.

Sipërfaqja e përfshirjes për të cilën përpunohet Dokumentacioni lokal urbanistik planor është 1513 m2.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike do të gjenden në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në sistemin E-urbanizëm.

Lajmërimi për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike, shtojcën grafike për Dokumentacionin lokal urbanistik planor për G4 - Depo me sallon ekspozues për PK 130/1, KK Bardovc, m.v Gllaviçicë, Komuna Karposh, Shkup dhe informacione më të hollësishme për të njëjtat do të publikohen në UEB faqen e Komunës Karposh - www.karpos.gov.mk.

Në afatin e caktuar, subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mund të parashtrojnë vërejtjet në listat anketuese në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në formë elektronike përmes sistemit informativ E-urbanizëm, në pajtim me nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

KRYETARI I KOMUNËS KARPOSH
Stefan Bogoev

Rabiot vendos të shkojë te Reali

Që nga janari Barcelona tentoi të firmosë një parakontratë me Adrien Rabiot, i cili në fund të këtij sezoni do të jetë lojtar i lirë, sepse ka vendosur të mos rinovojë me PSG-në. PSG akuzoi publikisht klubin katalanas se po negocionin në mënyrë të padrejtë me lojtarin e tyre dhe vetë Barça u përgjigj me një deklaratë zyrtare se nuk ka vendosur asnjë kontakt me francezin. Gjithsesi më vonë u zbulua se klubi dhe lojtari nuk gjetën akord për shkak të kërkesës financiare të kërkuar nga Rabiot. "El Chiriguito", media eksperte për merkato në Spanjë ka zbuluar se Rabiot do të shkojë tek Real Madrid, pasi ai do jetë pasuesi i Luka Modric në të ardhmen. Ky afrim është bërë me miratimin e Zidane, sipas medies spanjolle, duke qenë se trajneri ka lidhje me të gjithë lojtarët francezë.

REKA PËR REPUBLIKËN
BLERIM REKA PËR PRESIDENT
VOTO
1
blerimreka.org
#EuReka

DASHI 21. mars - 20. prill

Nëse jeni ne një lidhje sot duhet te bëni edhe me shume përpjekje për ta bere ambientin edhe me te ngrohte. Mos lejoni asnjë person tjetër t'ua prishe harmoninë. Beqaret nuk duhet te fiksohen për te filluar sa me pare një lidhje sepse mund te bëjnë gabime me pasoja për te ardhmen. Ne planin financiar Saturni do jete pozicionuar keq dhe ekuilibri do jete goxha i trazuar.

DEMI 21. prill - 21. maj

Jeta juaj ne çift do ketë goxha përmirësime sot dhe nuk do jeni me te mërzitur si me pare. Do jeni me largpamës dhe do bëni edhe surpriza. Beqaret do bëjnë disa gabime me sjelljen dhe nuk do arrijnë dot ta tërheqin pas vetes atë qe pëlqejnë. Ne planin financiar do jete Plutoni qe do ndikoje pafundësisht dhe do ju ndihmojë ta përmirësoni gjendjen me tepër nga sa mendonit.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Pas një periudhe delikate, ju te dashuruarit do arrini ta përmirësoni marrëdhënien me partnerin. Do e kuptoni tashme se te dy keni pasur fajet tuaja për çdo problem qe ju ka ndodhur dhe do mundoheni te gjeni zgjidhje. Beqaret nuk do kënaqen mjaftueshëm me takimet qe do realizojnë dhe do preferojnë te presin ende. Ne planin financuar situata mund te jete edhe paksa e ndërlikuar

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Sot do dashuroheni pa dorashka me atë qe keni ne krah dhe emocionet kane për te qene te forta. As personat me te bukur nuk do arrijnë dot t'iu joshin pasi ju keni sy vetëm për partnerin. Beqaret do realizojnë një takim fantastik, i cili do i bëjnë te përhumben tërësisht. Ne planin financiar duhet t'i dëgjoni me kujdes këshillat e familjareve sepse ata duan t'iu ndihmojnë.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Jeta juaj ne çift do jete goxha e këndshme sot. Do i qëndroni shume besnike partnerit tuaj dhe do i bëni atij disa surpriza qe nuk i priste. Emocionet do ju pushtojnë dhe do kënaqeni pafundësisht. Beqaret do jene strikte me kërkesat dhe nuk do gjejnë dot një person fiks ashtu si e duan. Ne planin financiar mos ndërmerrni shume rreziqe edhe sikur situata te jene e kënaqshme.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Nëse nuk doni qe rutina ta shkatërrojë lidhjen tuaj me partnerin duhet patjetër t'i shtoni dozat e imagjinatës gjate kësaj dite. Dilni, argëtohuni dhe surprizojeni sa te mundeni njeri-tjetrin. Beqaret do dine si ta joshin personin qe pëlqejnë dhe shume shpejt do e ndryshojnë statusin. Ne planin financiar nuk do keni asnjë lloj problemi kështu qe mund te kryeni edhe disa shpenzime me shume.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do ia shprehni me tepër ndjenjat njeri-tjetrit sot dhe marrëdhënia me partnerin ka për te qene fantastike. Asgjë e keqe nuk do ndodhe mes jush. Beqaret duhet te reflektojnë disa hare para se te hedhin hapa ne mënyrë qe te mos lëndohen. Buxheti do jete i qëndrueshëm pasi ju do kujdeseni për çdo gjë ne çdo moment. Vazhdoni kështu dhe do e shihni qe gjithçka do ndryshoje.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Priten mosmarrëveshje te njëpasnjëshme sot mes jush dhe atij qe keni ne krah. Nuk do merreni vesh për asgjë me partnerin dhe ne çdo moment do doni te dale e juaja. Beqaret do jene me fat ne dashuri dhe do e gjejnë personin me te përshtatshëm. Perspektivat financiare duken te jashtëzakonshme. Përfitoni për te hequr para mënjanë qe te siguroni fort edhe te ardhmen.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Për pjesën me te madhe te çifteve, jeta juaj ne çift ka për te qene e mire sot. Do jeni te dy palët te qete dhe te kuptueshëm ne çdo moment. Beqaret nuk duhet t'iu besojnë te gjithë personave qe do i joshin sepse disa mund t'i lëndojnë pamase. Buxhetin do dini si ta menaxhoni ne çdo moment dhe situata do mbetet e njëjtë. Nuk do keni as problemin me te vogël ne këtë sektor.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dielli dhe Marsi do bëhen bashke gjate kësaj dite duke krijuar një klime shume te ngrohte për jetën tuaj ne çift. Pranë partnerit do përjetoni kënaqësi si kurrë ndonjëherë me pare. Beqaret duhet te reflektojnë me shume kujdes para se te hedhin hapa edhe pse ne fakt mundësitë sot duket te jene te mira. Financat do vazhdojnë te mbeten te njëjta edhe sot.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Bashkëpunimi i Marsit me Venusin do bëjnë qe klima ne jetën tuaj ne çift te përmirësohet tej mase sot. Nuk do keni asgjë për çfarë te qaheni, përkundrazi emocionet do jene me te forta. Beqaret me ne fund do fillojnë një lidhje te qëndrueshme. Ne planin financiar gjendja do jete e mire, kështu qe mund te kryeni edhe transaksione apo investime me vlere.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Nëse jeni ne një lidhje sot keni për te kaluar një dite mjaft te qete. Nuk do keni aspak probleme me partnerin tuaj, përkundrazi mund t'iu vini kapak edhe atyre te mëparshmeve. Beqaret duhet te presin edhe pak kohe para se te marrin vendime. Ne planin financiar do keni pak vështirësi, por me përkujdes dhe maturi çdo gjë do e kaloni shpejt.

						Mensur Mamuti	AUTORI LUSHNJAN NË FOTO	VEPËR E AUTORIT NË FOTO / KURESHTJE	K	NË SASI TË VOGËL
						BASTUN				
						SHPEND SHTËPIAK / FLOKË ARTIFICIALE				
						P				
						MINDER				DY ZANORE
						QAR, PËRFITIM				
						JO I BARDHI / URUGUAJI				
KOHA	BANORËT E GADISHULLIT ARAB	FJALOR	SHKO	TEMPERATURA	ERA E KEQE, GRAHMA / E KUNDËRTA E PERIHELIT					VENDI KU PASTROHEN MËKATET, SIPAS BESIMEVE MISTIKE FETARE
AFROVA						BEND HEVI METALI AMERIKAN / STUDIUES I ONOMASTIKËS				
DREJTIM NË MUZIKË				VEND NË HOLANDË / KRYEJ (DIÇKA						
AKIL KOCI			KËNGËTARJA PAT / DIGË GRAVITETI NË SPANJË, DAM							
EMËRTIM PËRKËDHELËS PËR BABANË / PËRZË, LARGOJ								DY BASHKËTINGËLLORE		
D					KRYQËZIMI I PELËS ME GOMARIN / MANCHESTER UNITED					
PJESA E MISHTË E TRUPIT				FUQIA E PËRKOHSHME E DEPUTETIT / LUMË (SPANJ.)						
KOHA	KËNGËTARJA FRËNGE, LETISIA / BARIUMI							NEGACION I HUAJ / MELIHATE AJETI		
ÇOBAN / VEPËR E AUTORIT NË FOTO					ISH KRYEMINISTRI KIRGIZ, SARIJEV / GJERMANIA					
B							KALI I SHALËS			

ZGJIDHJET: K, SHKOP, PULA, PERUK, NIM, DOBI, I ZIU, USIA, AVITA, OTEP, ROK, FOLLEBU, AK, BENATAR, BABËLOK, LLG, DËBOJ, MUSHKA, TUL, MANDAT, LARUSO, NO, BARI, TEMIR, BARKODI, ATI.

Sudoku

shumë i lehtë

	2		9			8		
				2	8	4	5	
						3		2
				8				4
7			6		4			1
9				1				
8	6	1						
	9			5	3			
		2	4				7	

mesatar

				7				
	9	5	1	6	2			
	7		4		5			
	8	2				3	1	
4	1						6	2
	3	7				9	8	
			8		4		5	
			7	5	6	1	9	
				1				

Shumë i lehtë: 524936817, 673128459, 189547362, 216385794, 735694281, 948712635, 861279543, 497853126, 352461978. **Mesatar:** 146378529, 395162478, 278495631, 682947315, 419583762, 537621984, 961834257, 824756193, 753219846.

"SHAMUKH", KRIJOHET PARFUMI MË I SHTRENJTË NË BOTË

Një parfumeri në Emiratet e Bashkuara Arabe pretendon se ka krijuar parfumin më të shtrenjtë në botë. Ai quhet "Shamukh", që në arabisht do të thotë "Ti meriton më sublimen", e çmimi llogaritet në 1.295.000 dollarë për 3 litra. Prodhuesit thonë se parfumi është rezultat i tre viteve kërkimesh dhe 494 eksperimentesh për arritjen e aromës më të mirë. Ai vjen me një shishe kristali italian "Murano", e zbukuruar me një fajkua floriri, kuaj arabë, trëndafila dhe një glob, e ka dhe 3.571 diamante, që në total mbërrijnë në 38.55 karat, perla gjigante, 2.5 kilogramë floriri të pastër 18 karatësh dhe 5.9 kilogramë argjend. Shishja e stërmadhe qëndron në një mbështjellëse lëkure gati dy metra të lartë. Krijuesit e parfumit thonë se ai ka përbërës që vijnë nga pjesë të ndryshme të botës, duke përfshirë drurin e sandalit, një lloj trëndafili turk, e një erëzë të veçantë indiane, ndërsa kafshët e paraqitura aty tregojnë historinë e Dubait. Shishja vet për çdo rast i ka arritur deri tani dy çmime "Guinness", atë të shishes së parfumit me numrin më të madh të diamanteve në botë, si dhe të shishes më të lartë të komercializuar me aromë, lëvizja e së cilës kontrollohet në distancë.



Priftërinjtë djegin librat e Harry Potterit

Priftërinjtë katolikë në veri të Polonisë dogjën librat, duke përfshirë një seri librash rreth magjistarit Harry Potter dhe gjëra të tjera të pretenduara nga pronarët e tyre se ata përmbajnë forca të këqija. Imazhet e djegies në Gdansk u botuan në Facebook nga një fondacion katolik që përdor metoda të pazakonta të punës fetare, raporton AP. Fondacioni tha se djegia e librave duhet të paralajmërojë anëtarët e famullisë për ndikimet e këqija që "vijnë nga magjia dhe okultizmi". Komentuesit në Facebook dënuan djegien e librave duke thënë se ajo përkujton zhvillimet e njëjta që ndodhën në Gjermaninë Naziste para Luftës së Dytë Botërore.

E lodhur duke pritur burrin ideal, gruaja martohet me veten

Një grua është martuar me vetveten pasi është mërzitur e lodhur duke pritur që të shfaqet i dashuri "i duhur" për t'u martuar. Një instruktore fitnesi 40 vjeçare, Laura Mesi nga Italia, ka bërë një pakt me veten që nëse nuk e takon 'të duhurin' deri t'i bëjë 40 vjet, ajo do të martohej me veten, e kjo është pikërisht ajo se çfarë ka bërë Mesi, transmeton koha.net. Pas 20 vitesh kërkimi, ajo më në fund hoqi dorë, e vendosi që ta çojë veten drejt altarit. Duke folur për gazetën Italiane "La Repubblica", Mesi tha: "U kam thënë shoqërisë e familjes që nëse nuk e gjej shpirtin tim binjak deri në ditëlindjen e 40-të, unë do të martohem me veten". Edhe martesa e saj ishte shumë kushtueshme, me një fustan nusërie që ka kushtuar 10 mijë euro, unazë speciale madje edhe torte martesash të bërë me një fotografi të gjatë të saj. Ajo kishte shtatëmbëdhjetë të ftuar për ditën e saj të rëndësishme, e në dasmën e saj kishte edhe ushqim e pije të shumta, kërcim e madje kishte edhe shishe të shampanjës në cilat ishte e shkruar "Single". Ajo madje ka planifikuar muajin e mjaltit për në Egjipt. Pavarësisht se ndjehet e lumtur për ceremoninë e saj, Mesi gjithashtu ka pranuar se nëse e takon ndonjëherë "të duhurin", ajo do të ndihet e lumtur që të divorcohet me veten e saj për burrin e vërtetë.

Fansi merr kafkën e gjyshit për të festuar titullin e kampionit

Racing Club ka fituar titullin e 18-të të Primera Divizionit në Argjentinë falë një barazimi 1 me 1 me Tigres të dielën. Rezultati e çoi Racingun drejt titullit të ardhshëm të kampionit, ndërsa siç pritej, tifozë të shumtë pushtuan Buenos Airesin për të festuar.

Një tifoz i Racingut, Gabriel Aranda, mori të gjithë vëmendjen gjatë festës, pasi kishte marrë me vete kafkën e gjyshit të ndjerë për të "mos e humbur festën". Edhe pse gjithçka u ngrit në formë dyshimi për shkak të Ditës së Gënjeshtrës, TNT Sports arriti të fliste me Arandan. "Do të jetë krenar sepse e kam nxjerrë dhe e kam marrë", ka thënë Aranda gjatë intervistës.

KALENDARI HISTORIK 3 PRILL

1376 - Beteja e Naxherës, Anglezët mundin Francën

1559 - Spanja dhe Franca nënshkruajnë Traktatin e Dytë të Le Cateau-Cambrésis.

1783 - Suedia dhe SHBA nënshkruajnë Traktat për Paqe dhe Tregti.

1917 - Lenini largohet nga Zvicra për në Petrograd.

1919 - Austria dëbon të gjithë Habsburgët.

1941 - Çerçilli paralajmëron Stalinin për sulmin e Gjermanisë.

1949 - Traktati Veri-Atlantik nënshkruhet nga SHBA, Britania, Franca dhe Kanadaja.

1964 - SHBA dhe Panamaja pajtohen të rindërtojnë marrëdhëniet diplomatike.

1977 - Kryetari i Egjiptit Anuar Sadat për herë të parë takohet me kryetarin amerikan Xhimi Karter.

1988 - Somalia dhe Etiopia pajtohen në lidhje me shkretëtirën e Ogadenit.

A E DINI SE...

Mendoj se ju ka ndodhur edhe juve, rreth 68% e njerëzve kanë zhvilluar "sindromën fantazmë të vibrimit" ku besojnë se telefoni i tyre në xhep ka vibruar e në fakt nuk e ka bërë.

Personat që kanë marrë pjesë në skenën e të shtënave ndaj turmës në dasmën e Don Corleone në "The Godfather" ishin me të vërtetë gangsterë dhe të afërm të tyre.

Lufta më e gjatë ka zgjatur 115 mes Francës dhe Anglisë ndërsa ajo më e shkurta në vitin 1896 mes Britanisë dhe Zanzibarit që ka zgjatur vetëm 38 minuta.



BARSOLETA

NDIKIMI

- A e di që djali im i madh është kopja ime?
- Po kjo ndodh për shkak të ndikimit të gjeneve.
- Vërtet? E pse djali im i vogël ngjan me fqinjin?
- Ajo ndodh për shkak të ndikimit të rrethit.

THËNIA E DITËS

Femrat mund të jenë të afta të imitojnë orgazëm, por meshkujt janë të aftë të imitojnë një lidhje.

(Sharon Stone)